

**SEANCA E KUVENDIT E  
MBAJTUR MË 13.6. 2002**

**Seancën e kryeson Fatmir Sejdiu, nënkryetar i Kuvendit.**

Më lejoni që të hap punimet e seancës së tetë të Kuvendit të Kosovës. Siç jeni njoftuar edhe me ftesën në seancën e sotshme propozohet rendi i ditës, i cili është bashkangjitur poashtu ftesës në një debat mbi rregulloren e krijimit të Agjencionit të Mirëbesimit të Kosovës. Nën dy, emrimi i anëtarëve të rinj të komisioneve të Kuvendit. Nën tre, të ndryshme.

A pajtoheni me këtë rend pune që të vazhdojmë. Kush është për. Ju falënderit. Konstatoj se Kuvendi miratoi rendin e ditës dhe mund të vazhdojmë me punë. Para se të çasemi pajtimit të pikave themlore të rendit të ditës më lejoni dy informacione të shkurtëra t'jua prezentoj. E para se një grup i deputetëve të Kuvendit të Kosovës të udhëhequr nga kryetari i Kuvendit të Kosovës akademik Nexhat Daci gjendet në një vizitë pune, ta quajmë Shteteve të Bashkuara dhe Qeverisë Amerikane dhe për disa ditë nuk do të jetë këtu, por ne do të vazhdojmë punën. Çështja e dytë, siç jeni informuar nga mjetet e informacionit dhe nga ajo që ne kemi pritur me kohë, Qeveria e Kosovës është kompletuar edhe me ministrin e një sektori shumë të rëndësishëm të sektorit të bujqësisë, të sektorit të pylltarisë dhe të zhvillimit rural dhe ky është zotëriu nga kualicioni, "Kthimi" z. Goran Bogdanoviq. Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës një debat për rregulloren e Agjencionit të Mirëbesimit në Kosovë besoj se deputetët kanë materialet, përkatësit draftregulloren mbi themelimin e këtij agjensioni para vehtes, të njejtën kohë tju informoj se dia nga komisionet e Kuvendit, përkatësisht komisioni i buxhetit ka pasur një shqyrtim brenda komisionit rreth këtij drafti dhe sigurisht ka qëndrimet e veta. Poashtu Qeveria e Kosovës ka trajtuar këtë problematikë dhe ka shiqimet e veta rreth kësaj sikur që ashtu keni përcjell, kujtoj se disa nga institucionet e rëndësishme të Kosovës, si Oda Ekonomike e Kosovës, Instituti i Investit, Sindikatat e Bashkuara të Kosovës, edhe ndonjë asociacion tjetër kanë bërë shqyrtimet vetanake lidhur me te, para se të jap fjalën, do të lusja kryetarin e Qeverisë së Kosovës z. Bajram

Rexhepi që të qes para jush shiqimet e Qeverisë lidhur me këtë dokument që ne bashkarisht do ti bashkangjesim edhe qëndrimet tona duke pasur parasysh edhe debatin e sotshëm dhe do tua dërgojmë në procedurë të mëtejshme meqë Kuvendi nuk do të vendosë në kuptimin e miratimit të këtij dokumenti, e keni fjalën z. kryeministër.

## **Z. KRYEMINISTËR BAJRAM REXHEPI ,**

E nderuara Kryesi e Kuvendit, i nderuari kresuesi i Kuvendit, të nderuar deputetë. Unë desha që kërkesat e Qeverisë të shpjegoj cilat prej kërkesave tona janë pranuar nga përfaqësuesi i sekretarit të përgjithshëm z. Shtajner. Kan qenë të sublimuara 10 kërkesas të Qeverisë dhe disa prej tyre janë pranuar dhe disa mbesin që me politikat operacionale të realizohen dhe të shqyrtohen ato mundësi, Kisha desht që shkurtimisht t'ju informojë pik, për pikë kërkesat të cilat janë pranuar dhe të cilat planifikohen që me politika operacionale të pranohen në vazhdim.

Propozimi i Qeverisë ishte që të tre drejtorët të cilët marrin pjesë në bordin e drejtorëve të Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit të jenë ministrat , për arsye se aty nuk ka qen e prezicuar përfaqësuesi i komunitetit serb nuk ka qen i precizuar se a duhet të jetë ministër prandaj na kemi kërku që të gjithë ata të jenë të një niveli të njejt pra kjo është pranuar nga përfaqësuesi speical, poashtu ka qen kërkesë e jonë që gjithashtu të kyqet kryetari i sindikatave të Bashkuara të Kosovës të jetë anëtar i bordit të drejtorëve edhe poashtu edhe kjo është pranuar, prandaj është numri për kryetarin e sindikatave të Kosovës, Qeveria ka kërku poashtu që njeni prej drejtorëve të këtij bordi të jetë kosovar, prej nënkryetarëve të bordit pra është pranuar kërkesa jonë që nënkryetarit të bordit ti takoj kosovarëve , pra edhe kjo kërkesë e jona është pranuar .

Qeverija ka kërku që drejtori menagjus i Agjensisë të jetë kosovar, është pranuar, por nëndrejtor menagjues i Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit një prej tyre të jetë kosovarë. Është kërku poashtu që kosovarët të jenë partner të barabartë gjatë procesit të operacionalizimit, për procese të privatizimit dhe në këtë drejtim është pranuar që dy për shkaqe të sigurisë kosovar të marrin pjesë në krijimin e rregulloreve për politikat operacionale e këta në mbledhjen e mëparme të Qeverisë janë pranuar edhe emrat nga Qeveria dhe këta janë z. Fatmir Sejdiu, dhe z. Ahmet Shala të cilët do të jenë ata që do

të marrin pjesë në grupin e krijimit të rregulloreve për çdo ndërmarrje në mënyrë specifike. Kemi kërkuar gjithashtu mjetet që mblidhen nga procesi i privatizimit të mbeten në bankat kosovare dhe ato fonde të investohen në ekonominë kosovare në ato ndërmarrje të cilat kanë perspektiv dhe qojnë drejt një prosperiteti ekonomik. Kjo tash për tash ka mbet e pa përcaktuar për shkaqe të sigurisë, mirëpo ka gjasa reale se ato fonde do të deponohen në banka të cilat janë në Kosovë dhe ato fonde do të investohen në ekonominë Kosovare e jo ato të mbesin të ngrira.

Është kërkuar që pas llogarive të cilat bëhen nëse ka eventualisht kreditor apo pretendues të pronës që ato mjete që mbeten të drejtohen në fond të Qeverisë dhe pastaj të vendoset se në që drejtim do të prokurohen ato mjete. Kjo ka mbetur që të bëhet me politika operacionale, këtu nuk mund të themi se është pranuar apo nuk është pranuar. Kemi kërkuar poashtu që punëtorët të cilët kanë punuar nëpër ndërmarrje më parë të kenë të drejtë që të paraqiten si pretendent që të kenë aksione, mirpo kjo shkon nëpërmjet odës së veçantë të Gjykatës Supreme e cila do të përbëhet prej 3 ndërkombëtarëve dhe 2 kosovarëve, pra secili punëtor që ka punuar në të kaluar ka të drejtë të paraqes kërkesën për pronësi të ndërmarrjeve të cilat privatizohen.

Kemi kërku që gjithashtu gjatë procesit të privatizimit të bëhet transpaarenca e plotë, në këtë drejtim kemi kërkuar që përveç z Shtajner dhe Qeveria të informohete në mënyrë periodike në mënyrë që pastaj kjo transparenc në Qeveri të distribuohet edhe nëpër media në mënyrë që edhe medijat edhe qytetarët e Kosovës do të jenë të informuar me procesin e privatizimit që mendoj se është bazë e një suksesi. Poashtu na kemi kërkuar që të mund të ketë sukses procesi i privatizimit poashtu në këtë fazë sa më shpejt që është e mundur të rumbullaksohen edhe ligjet si ligji mbi pronën, ligji antikorrupsion, ligji mbi regjistrimin e biznesit, ligji mbi tregun e aksioneve dhe ligji e rregullore administrative të cilat e ndihmojnë procesin e privatizimit, pra mund të themë se një pjesë e madhe e kërkesave tona që kanë qenë janë pranuar, ndërsa të tjerat do të bëhen me politikat operacionale. Poashtu nuk dua t'i përsëris fjalët e kryesuesit sepse kjo temë është diskutuar edhe në Odën Ekonomike, në riinvest dhe në komisionin për buxhet dhe sigurisht edhe ju të nderuar deputet do të diskutono në lidhje me këtë por mund të ju them që gjatë vizitës së fundit që kishim në Zvicër për inkurajimin e biznesit si me anëtarët e diasporës sonë, poashtu edhe me disa kompani

zvicëra, çështja e parë që është kërkuar se a egziston ndonjë legjilscion, dhe a egziston ndonjë agjensi e privatizimit, prandaj mendoj se është shumë e rëndësishme që kjo Agjensi e privatizimit të fillojë punën sa më shpejt, na jemi të vetëdijshëm edhe për përkufizimet që i kemi në bazë të Kornizës kushtetuese dhe mendoj se në kohën kur investitorët e huaj janë të gatshëm të investojnë në Kosovë është shumë me rëndësi që edhe ju ta jepni fjalën dhe kjo agjensi kosovare e mirëbesimit të fillojë sa më shpejt të funksionoj, Ju falënderit për vëmendje.

**Z. SEJDIU**, falënderit z. Kryeministër. Sipas asaj që paralajmërova I us deputetët, përfaqësuesin e Komisionit të buxhetit në këtë rast, deputetët e tjerë, sikurse edhe nga Qeverija, përkatësisht nga ministria e ekonomisë dhe fionancave sipas nevojës pra sipas asaj që e shohim të nevojshme të bisedohet rreth këtij dokumenti të rëndësishëm të marrin fjalën. Fjalën e ka ministri i ekonomisë dhe financave z. Ali Sadriu.

**Z. ALI SADRIU**,

Faleminderit për rastin e dhanun kam kënaqësinë ti ju përshëndes ju Kryesi e nderuar dhe ju kolegë të nderuar. Ne konsiderojmë privatizimin si një qëllim qenësor të politikës ekonomike të Kosovës, privatizimi është i rëndësishëm vendimtare për popullin ekonominë stabilitetin dhe sovranitetin e Kosovës . Asnjë vend në botë sdo të jetë në gjendje që të arrijë zhvillime të larta ekonomike dhe mirëqenie të popullit të vet pa një sektor privat të fuqishëm dinamik dhe konkures. Ndikimet në sektorin publik, ne nuk e shohim privatizimin si një masë me qëndrime armiqësore drejt sektorit publik dhe të drejtave kundër drejtësisë sociale dhe prospereitetit, privatizimi është një masë që do të forcojë sektorin publik do të ndihmojë në rritjen e efikasiteti të vet, të shërbimieve publike do të lirojë buxhetin tonë nga subvensionet e shtrenjta do të krijojë vende të reja të punës, do të gjeneroj të hyra për punëtorët, tëndërmarrjeve dhe të hyra tatimorre për buxhetin që do të mundësojë finansimin e shëndetësisë, arsimit programeve tona të sigurimit social dhe implementimin e ligjit dhe rendit.

AKM-ja në këtë kontekst, themelimi i Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit, është një ngjarje më e re në historionë e re të Kosovës, AKM do të themelojë një infrastrukturë institucionale të domosdoshme për një privatizim të rregullt, së shpejti transparenca, efikasiteti dhe korrektësia, duhet të theksojnë rëndësinë e këtyre 4 faktorëve shumë të rëndësishëm për privatizim.

Shpejtësia, e shpejtësia e privatizimit është me rëndësi të madhë, po e humbim shpejtësinë po e humbim garën në kohë, sa më shumë që na duhet për të implementu programin tonë të privatizimit, aq më i lartë do të jetë qmimi, nëse e shtyjmë edhe mëtej privatizimin, gjëja e vetme që do të na mundësojë do të mbetet, apo do të mbetet për tu privatizu, mund të jetë në gërmadha pa vlera, ndërtesat, një ushtri e punëtorëve të papunë, të varfur, shënimet për ndërmarrjet shoqërore ne i kemi në dispozicion, përshkruhet një situatë e mjerueshme momentalisht vetëm 40% e kapacitetit prodhues të ndërmarrjeve shoqërore shfrytëzohet, shumë prej këtyre ndërmarrjeve janë 100% jo efektive, numri i punëtorëve aktiv është shumë i ulët dhe është duke ra në fakt sipas disa vlerësimeve jo ma shumë se 30 mijë persona janë të përdorur, gjegjësisht punojnë në ndërmarrje shoqërore, kjo në të vërtetë është vetëm 3% e fuqisë së përgjithshme punëtoare, të puntorisë Kosovare. Pagat e tyre janë më të ultat në Kosovë, shpesh edhe nën 100 euro në muaj ose edhe më pak p.sh. ½ nën nivelin aktual mesatar të pagave mujore në Kosovë, numri joaktiv i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë është i lartë dhe është duke u rritë, kjo situatë kultivon papunësinë dhe varfërinë vetëm 7% të ndërmarrjeve shoqërore janë njerëz të ri, 30 e më pak të vjetër, shansat që të diplomuarit e ri nga shkollat tona të gjejnë punë në këto ndërmarrje janë të afërta me 0.

Dhe derisa për të gjitha sistemimet e ndërmarrjeve shoqërore nuk gjinden edhe të drejtat e pronësisë, apo të sqarimit të pronësisë ne vazhdojmë të humbim jo vetëm kapitalin e qmuar të ndërmarrjeve egzistuese, por gjithashtu pengojmë krijimin e firmave të reja, të vendeve të reja të punës së cilat do të sigurojnë të ardhura dhe dhe mundësi të punësismit të kapitalit tonë më të çmuar gjeneratën e re mirë e edukur.

Sipas vlerësimeve tona gjatë vitit të kaluar vlera e grumbulluar e ndërtesave dhe e pajisjeve në ndërmarrjet shoqërore ka ra nga 0,5 në 1 miliard euro apo 1 e katërta e vlerës së tyre. Ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet publika së bashku gjatë dy viteve të fundit kanë kontribuar në bugjetin e përgjithshëm të Kosovës me vetëm 17 milion

euro, çka është më pak se 5% nga të hyrat e përgjithshme të mbledhura nga tatimet dhe shërbimet tjera.

Kryesuesi, z. Ministër, do ta ju lutesha që të jeni më të shkurtër dhënien e argumenteve që janë tepër të nevojshme për shkak të kohës, Ju falënderit,

Transparent është një atribut i procesit të privatizimit me arsy të madhe, përvoja ndërkombëtare e dekadës së fundit është tillë që shkalla e suksesit dhe tentativa dhe të ndryshme për privatizim me vendet e Evropës qendrore dhe lindore ka qenë në përpjestimi me transparenca herë, herë jo të mjaftueshme, transparenca jo vetëm në gjetjen e blerësve më të mirë për fitimin e ofertave më të mira e rritë në mënyrë dramatike shansin për sukses për shitje roli i AKM-së në blerjen e të gjitha transaksioneve me transparenca është fundamentale, për këtë na nevojitet një status shumë transparent i vetë AKM-së dhe duhet të sigurojmë autonominë e saj në mënyrë që t'i mundësojmë këtij Agjensioni që të veprojë lirshëm, pa presione nga lobet politike nga grupe të caktuara me qëllime të caktuara dhe elemente, dhe eventualisht elementeve kriminale.

Ne duhet të themi transparenca. Këtu duhet të kuptohet gjërësisht në kuptimin, jo vetëm të procedurave të shitjes të përdorura në këtë proces, por gjithashtu që ka të bëjë në informata të përfshira në të gjitha fazat e privatizimit. Qeveria jonë dhe populli jonë ka nevoja të mëdha për statistikën e mira që informojnë dhe japin informata të besueshme për gjithë sektorët e aktiviteteve aktuale të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike investuesit do të kenë nevojë të madhe për informata të besueshme për statusin e ndërmarrjes që ato të dëshirojnë ta blejnë mungesa aktuale e informatave të besueshme, për statusin e ndërmarrjes që ato të dëshirojnë ta blejnë. Mungesa sa aktuale e informatave pengon politikat e mira, procedurat e mira drejt privatizimit dhe ndarje të mjaftueshme të fondeve investuese përdersia kultivon korrupsioni dhe mosbesimi, një punë tjetër e rëndësishme do të jetë kampanja e një shkalle të gjërë në medijia të shkruara dhe elektronike e cila do të bmulonte popullin dhe njerëzit e interesuar për informata dhe në të njëjtën kohë do të tërhiqte ofertuesit më të mirë nga Kosova dhe jashtë, procesi i ofrimit duhet të organizohet në aso mënyre që askush, nuk do të inshte në gjendje të parandaloj asnjë investues të interesuar për pjesëmarrje opo metode ilegale qoftë.

Në vend transparenca duhet të përcaktohet në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me statusin e pronësisë, përderisa përderisa satusi i pronës i dërmarrjeve shoqërore në ndërmarrje publike mbetet j otransparent a shtu siq është, ne nuk mund të presim në përmbushjen e tyre një detyrë kryesore për AKM-në do të jetë që të qartësojë këtë rrëmujë dhe të bëjë të gjitha të drejtat pronësore të sakta dhe transparente.

**Z. FATMIR SEJDIU**, ju lus z. ministër që të rrumbullaksoni do të racionalizojmë edhe në kuadër të kohës së caktuar, ju lus

Pra unë po e dorëzoj materialin pasi që e kam të shkruar, po edhe ashtu ban, nël qoftë se keni ndonjë fjal për përfundim.

Ajo që Qeverinë e Kosovës e brengos nga gjithë ky proces është ajo që mosgadishmëria, apo mosofrimi i mundësisë që Qeveria nga mjetet e shitura të ndërmarrjeve që do të privatizohen të mund të operoj sipas planprogrameve dhe prioriteteve të saja është një breng për të cilën ne si qeveri dhe si popull mendoj se edhe mëtutje të jemë në kërkesë që edhe kjo ti mundësohet, një çështje tjetër që është mjaft e avansuar që është mundësu që mjetet do të jenë në bankat me seli në Kosovë, dhe gjithsesi ky proces është shumë i ndërlikuar dhe kërkon angazhimin e të gjitha strukturave, medijat një rrol të jashtëzakonshëm në këtë proces do të duhet ta luajnë, Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, për fjalë është paraqit Fatmir Rexhepi nga komisioni i buxhetit, pastaj deputeti Bujar Dugolli dhe deputeti Ramadan Kelmendi dhe deputeti Bislim Hoti, po mirë le të përcjellim këtë rend,

**Z. FATMIR REXHEPI**,

Zonja dhe zotërinj teputet e nderuara kryesi, edhe në komisionin e buxhetit është shqyrtuar kjo çështje që është shumë me rëndësi do të thotë themelimi i agjensisë së mirëbesimit të Kosovës dhe rregullorja që përcakton statusin dhe çështjet me të cilat ngarkohet kjo Agjensi, prandaj rregullorja mbi AMK dhe privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore duke u nisur nga fakti seprivatizimi paraqet prioritet në kuadër të politikave ekonomike dhe aktivitete në ndërtimin e ekonomisë së tregut, këtij procesi i japim

mbështetje të plotë, rreguloren për AMK e përkrahim në parim por vlerojmë se duhet të merren parasysh edhe disa çështje gjatë diskutimit dhe plotësimit të saj, nën një , meqë Agjendisoni i mirëbesimit të Kosovës me rregullore parashihet të admijnistrojë me kapitalin dhe pasurinë shoqërore të Kosovës brenda saj duhet që të ngritet rroli i institucioneve të Kosovës krahas KSSP-së në formimin e AMK-së si dhe në krijimin e politikës së privatizimit.

Nën dy agjensioni dhe organizimi i saj duhet të ndryshohen sepse, kapaciteti dhe efikasiteti i agjensisë për të bërë administrimin e plotë të 400 ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, që nga zgjedhja dhe strukturat udhëheqëse dhe të mbikqyrjes politikat e menagjimit financiar, kontrollin, transformimin, privatizimin fondet etj. Është i vogël prandaj kërkon që bordi udhëheqës të zgjerohet edhe atë duke u rritë numri i kuadrove që do të përfaqësonin institucionet e Kosovës.

Nën tre, fondet e krijuara në kujdestari të MKM-së dhe vërejtjet tona. Shoqëria kosovare është pronare e ndërmarrjeve shoqërore, prandaj mbi këtë bazë do të ishte mirë të krijohet dhe menagjohet fondi i privatizimit nga shitja e aksioneve të kompanive të dala nga ndërmarrjet shoqërore, sepse sipas rregullore AMK- mban në kujdestari të ngrira këto fonde jashtë funksionit ekonomik, duke mos krijuar fondin e privatizimit si sinstitucion të veçantë për shkak të mospërfundimit të zgjidhjes së pretendimeve pronësore. Çpasja e tillë e gabuar mund të bëhet shkas i tensioneve sociale dhe politike sepse shoqëria kosvare dhe punëtorët e ndërmarrjeve janë akterët e vetëm legal të kësaj prone duke mos i cecuar e obligimet ndaj kreditorëve, kështu rregullorja duhet të merrë parasysh dhe të bazohet mbi ligjet e ndërmarrjeve shoqërore dhe ekonomike të para 22 marsit të vitit 1989 të cilat përcaktojnë themeluesin, karakterin dhe pronarin e sajë, poshtu janë të papranueshme tendencat që pas kësaj date të merret parasysh ndonjë nga elementet e transformimit të dhunshëm që ka bërë serbija përmes gjenocidit dhe masave të jashtëzakonshme në ekonomi dhe kudo tjetër në Kosovë kështu asaj tani duhet kërkuar kompenzimin e shkaktuar për 10 vite e jo ti lejohet ndonjë e drejtë që të përzihet në çështjet pronësore të Kosovës përmes kinse ligjeve të aplikueshme.

Nën katër, vlersojmë se modeli që fondi të mos ngrihet 100% por të jetë në përdorim është më i arsyeshëm, sepse ky fond në vazë të vendimeve të parlamentit dhe me një koncezus me përfaqësuesin special të sekretarit të përgjithshëm do të mund tël

ndihmonte shumë në këtë fazë krahas privatizimit edhe atë në disa drejtime, krijimin e vendeve të punës, asistencës sociale, fondin e pensionistëve investimet, investime në infrastrukturë etj.

Nën pesë, qështja e pronës dhe transformimi i saj për të pasur sukses të plotë si në çdo vend, pra edhe në Kosovë kërkon koncensus shoqëror dhe transparencë. Kështu raportimi i AMK-së të parlamenti dhe Qeverija si dhe participimi i këtyre institucioneve në krijimin e politikës së privatizimit dhe dhe në zbatimin e saj drejtëpërsëdrejti do të reflektonte pozitivisht në opinionin vendor dhe të garantonte proces të suksesshëm, vlerësojmë se këto vërejtje do të ndihmojnë shumë në këtë fazë dhe se nuk do të lihen anash me plotësimet e reja që duhet të bëhen dhe të përfshihen në rregulloret mbi AMK-në si dhe ligjet mbi privatizimin që do të hartojë Kuvendi, Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, ju falënderit, fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

**Z. BUJAR DUGOLLIL,**

E nderuara Kryesi e punës, të nderuar deputetë, grupi parlamentar për ardhmërinë e Kosovës në kërkesën që i ka drejtu Kuvendit më 23 maj të vitit 2001 ka kërkuar që projektregullorja, apo draftregullorja të dorëzohet Kuvendit në shqyrtim dhe njëkohësisht komisionet të bëjnë propozimet e veta në formë të shkruar dhe tëju shërndajnë deputetëve para se të fillohet të dikutohet ose të bëhet debat rreth kësaj çështje megjithatë ne pam një raport të Komisionit e pam dhe e përshëndesim dhe dëshirojmë që edhe komisionet tjera të deklarohen për këtë, normalisht i përshëndesim propozimet që i ka bërë Qeveria por edhe një vërejtje për Qeverinë se nuk na ka njoftuar me shkrim se cilat propozime janë pranuar dhe cilat jo. Unë besoj se Qeveria do ta kuptojë se Parlamendit është organi i cili duhet të ipet llogari për punën e vet dhe jo të bëhet siq është bërë në betimin e djeshëm vetëm para përfaqësuesit special.

Megjithatë ne do të lexojmë vërejtjet, grupi Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës vërejtjet për projektregulloren e Unmikut për themelimin e Agjensisë së Mirbesimit, sipas projektit të propozuar për themelimin e AKM-së nuk është definuar në mënyrë të qartë mandati i agjensisë për privatizim, për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, por

merret vetëm me administrimin e ndërmarrjeve publike pa pasur perspektivë të qartë për privatizim. Propozojmë që neni 2 i kësaj projektregulloreje përkatësisht pika 2.1 t'i shtohet alineja e 2 dhe të thuhet AKM-ja në mënyrë të mirë dhe transparente të zgjedhë metodën e privatizimit që trajton hapur dhe ndershmërisht çështjen e menagjimit të pronës, interesat e punëtorëve dhe interesat e komunitetit të gjërë Kosovare. Në këtë propozim nënkuptohet se duhet ndryshuar edhe neni 6 dhe 8 i projektregullores së AMK-së. Nëse nuk definohet ky ndryshim sipas projektit të propozuar për themelimin e AKM-së kjo Agjensi më shumë do t'i përngjajë agjencisë për komercializim sesa agjencisë për privatizimin e pronës. Pa zgjedhje të qartë të pronës shoqërore nuk mund të funksionojë ekonomia e lirë e tregut, sepse tregu inauguron, zbulon resorset e definon bazën e transaksionit për investime dhe për marrëdhënie në mes aktive dhe private dhe rolin e shtetit në to. Duke bërë me dije se pa privatizim nuk është e mundur rimëkëmbja e ekonomisë kosovare, dhe as të hapen vende të reja të punës siq kemi premtuar, mundësitë e dhëna në këtë projekt paraqesin vështësi sepse komercializimi i ndërmarrjes shoqërore sipas anallizave të deritashme ka qen dështim për arsye se investitorët duke e futur në marrëveshjen nuk do të mundeshin në mënyrë të lirshme me që konceptet e pronës shoqërore nuk janë zgjedhur ende.

Sipas projektit të propozuar për themelimin e AMK-së kësaj agjencie i jipet e drejta absolute për mbikqyrjen e pronës shoqërore dhe publike të Kosovës. Megjithatë investitorët e huaj nuk do të investojnë në një ekonomi me një kontrollë të pafund të UNMIK-ut, sepse edhe administrata e tij duke u mbështetur në Rezolutën 1244 është e përkohshme, sepse sipas projektit të propozuar nuk precizohet se i menagjohen mjetet e fituara nga shitja e aksioneve, profiti i ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, si dhe likuidimet e ndërmarrjeve dhe për çka shfrytëzohen këto mjete, propozojmë që këto mjete të shfrytëzohen për këto qëllime, nga shitja e aksioneve do të bëhet ndarja e aksioneve për punëtorët dhe pjesa tjetër të formohet fondi i privatizimit kështu që shoqëria kosovare të përfitojë nga ky proces, nga profiti dhe mbetja e mjeteve nga likuidimi i ndërmarrjeve investohet në ndërmarrje shoqërore për të rritur vlerën e tyre ekonomike para se ato të privatizohen, sipas kësaj projekti nuk është parapar vlersimi i kapitalit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike para se të kryhet shitja e aksioneve dhe

të hapet procedura e likuidimit , për këtë arsye propozojmë që në një kapitull të veçantë të kësaj projektregullore të shtohet edhe ky vlersim.

Sipas projektpropozimit të nenit 3 përkufizimet ku definohet kuptimi i pronës publike dhe shoqërore dhe ku përmendet Republika e Serbisë dhe Republika Federaive e Jugosllavisë, të ndryshohet dhe të shkruhet, Republika Socialiste e Serbisë dhe Republika Socialiste e Jugosllavisë, sepse ligjet e aplikueshme në Kosovë janë të viteve para 22 marsit të vitit 1989 meqë në atë kohë kështu janë emëruar këto vende, ndërkaq nëse lildhet si është formulimi në projekt, mund të kuptohet se edhe ligjet e miratuara pas vitit 1989 mund ta aplikohen. Propozojmël që neni 5.4 të fshihet nga ky projekt sepse është i panevojshëm kur dihet se pas marsit të vitit 1989 të heqjes së autonomisë së Kosovës me dhunë, çdo veprim nga Serbia dhe Jugosllavia në Kosovë ka qenë diskriminues, jo legal, jo lelgjitem.

Ky nen mund të krijojë prejudiktime dhe konfuzion se e kujt është prona shoqërore në Kosovë, pra prona shoqërore e Kosovës ka qenë dhe do të jetë pronë e Kosovës, ajo nuk ka qenë dhe nuk është pronë shoqërore dhe shtetërore e Serbisë. Projektregullorja për themelimin e AKM-së ka lënë anash mënyrën e involvimit dhe të participimit të institucioneve të dala nga zhgjedhjet e lira në Kosovë, veçmas Parlamentit dhe Qeverisë, në asnjë vend nuk përmendet Qeveria , Kuvendi dhe as kryetari i Kosovës. Me përjaqshtim që po parashihet pjesëmarrja e dy ministrave në këshillin e drejtorëve të Agjensisë, në këtë aspekt do të duhet të shqyrtohet mundësia e zgjerimit të këtij këshilli edhe me përfaqësues nga Parlamenti, nga Oda Ekonomike si dhe nga sindikata. Gjithashtu për ti ikur procesit të politizuar të tepruar të këtij procesi nuk do të ishte preferuar që në rregullore të përkufizohet nacionaliteti i anëtarëve të këshillit siqë është bërë, ne mendojmë se kjo agjensi duhet të jetë transparente në punën e vetë karshi opinionit të gjërë , mendojmë se në draft duhet të caktohen disa afate për procesin e privatizimit poashtu ne kërkojmë që agjencia duhet ti jap raport pune edhe institucioneve vetëqeverisëse të Kosovës, si Parlamentit si organ më i lartë i vendit e Qeverisë, e jo vetëm përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara , sepse një çështje aq e rëndësishme për Kosovën, për këtë çështje punët dhe përgjegjësitë duhet ti ndajmë së bashku. Grupi parlamentar për ardhmërinë e Kosovës, është i bindur se këto propozime do të gjejnë mbështetje dhe do të pranohen, meqë në të

kundërtën ne nuk do të marrim përgjegjësi dhe nuk do të pranojmë projektregulloren e unmikut për themelimin e AMK-së, pa përfillur edhe vërejtjet e propozuara nga institucionet e Kosovës, konkretisht Parlamenti dhe Qeverija, unë këtë propozim do t'i la kryesisë, ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, për fjalë është paraqitur Ramadan Kelmendi, ju lutem.

### **Z. RAMADAN KELMENDI ,**

In deruari kryesues, e n deruara K ryesi, t ë n deruara d eputetë, t ë n deruar kryeministra . Duke shqyrtuar dhe analizuar në baza juridike dhe empirike këtë projektligj të rregullores së UNMIK-ut mbi themelimin e agjensisë kosovarere të mirëbesimit unë paraqes disa vlersime të mija të karakterit të përgjithshëm dhe të atij të veçantë, e para do të kishte qen e udhës dhe e drejtë që Qeverija dhe ministritë të na kishin paraqitur që më paarë me shkrim vërejtjet dhe sygjerimet dhe kërkesat e tyre për ndryshimin, gjegjësisht plotësimin e kësaj rrsregulloreje, me të vetmin qëllim që ne të kishim mundësi ti vrejme at. Shtroj një pyetje se kjo rregullore a është aplikuar në ndonjë vend tjetër të tranzicionit apo është një ekseriment i pari që bphet këtu në Kosovë, poashtu edhe komisionet e Kuvendit, nuk kemi raporte të tyre lidhur me këtë, por duke u bazuar në përmbajtjen e tekstit vërejtjet e përgjithshme konsistojnë sa vijon: Agjensia e Mirbesimit nuk krijon kushtet e mundësi për investime të reja në ndërëtimin e kapaciteteve as për zgjërimin e atyre egzistuese në sferën e ekonomisë e më saktësisht në degët e së cilës akumulojmë punësimin e mirëfillt të punëtorëve të rinjë. Dy nga kjo rrjedhë se edhe pronari i ardhshëm i ndërmarrjes i cili e blen atë ka për qëllim vetëm krijimin e profitit për nevojat e tij të cilat nuk i merrë boligimet dhe të drejtat e të punësuarëve që ishin të punësuar më parë aty ndërmarrje, Tre, në këtë aspekt Agjensia nuk krijon parakushte për krijimin e një strategjie të zhvillimit dhe restaurimit ekonomik nël tërsi të Kosovës nga kjo rezulton se menaxhimi i ndërmarrjes gjegjësisht menagjeri nuk bëhet për interesa të të punësuarëve, por vetëm për të krijuar pare dhe fitim individual. Dhe me këtë fitim do të vije në pyetje edhe ruajtja e ambientit të njeriut dhe të infrastruktursë së ndërmarrjeve egzistuese të cilat edhe kështu janë të dëmtuara , poashtu Agjensia nuk do

të krijojë kushte për planifikimin afatgjatë të zhvillimit ekonomik, ku me këtë privatizim nuk do të jetë në fokus të zhvillimit duke ditur se nuk do të zgjidhet teknologjia e cila siguron proceset e ndërmarrjeve, por ajo e cila i konvenon më tepër menaxhmentit, gjegjësisht privatistit.

Poashtu Agjensia nuk e mundëson një qeverisje të mirëfillt të ndërmarrjes dhe në këtë aspekt negativisht do të ndikojë në eksploatimin e pasurive natyrore dhe nëntokësore të Kosovës si dhe fuqisë së sajë punëtore e cila do ta kishte fatin të punësohej, kjo do të thotël se nuk mund të krijohet një strategji e ruajtjes së rezervuareve të tyre nga se pronari në mënyrë të interesit individual do të shfrytëzoj ato, kjo do të kektë si pasojë mosangazhimin në drejtim të krijimit të kapaciteteve prodhuese të produkteve, por vetëm në shfrytëzimin e pasurive natyrore dhe të fuqisë punëtore e tërë kjo shkon në drejtim të një perspektive mjaft të zymtë të ndërmarrjes si dhe në zhvillimin e tërsishëm të Kosovës dhe në veçanti në vend se të zbutet problemi i papunësisë me këtë do të pamundësohet zvoglimi, gjegjësisht rritja e punësimi.

Vërejtjet konkrete:

Shikuar nga aspekti gjuhësor, do të duhej të ishte projektligj mbi themelimin e Agjensisë kosovare të Mirëbesimit dhe do të ishte mirë që vërtet përkthyesit ta përdorin gjuhën shqipe juridike në shumë tekste që po na i prezentojnë. Dy, teksti është i përkthyer dobët, pa koncept të qyrtë juridik dhe ekonomik me çka humbet kuptimi i dispozitave ligjore dhe i përmbajtjeve ekonomike, neni 3 paragrafi 4 nuk përcakotn mënyrën se si përkaktohet pronësia, gjegjësisht kusht do të jetë pronar i infrastrukturës së ndërmarrjes ose thën më konkretisht i trungut ku ndërmarrja gjindet.

Në pasusin 7 të të njejtit paragraf të po këtij neni ngatërrohet koncepti korporat dhe kompani duke mos dhënë përkufizimet e duhura juridike dhe ekonomike ngase këto dy forma të organizimit dihen në aspektin juridik se si çka është kompanija dhe çka është korporata, në faqen 3 pasusi 4 ku ende nuk është aplikuar Ligji mbi ndërmarrjet, në Kosovë ky draft, gjegjësisht ky projektligj thirret në ligjin e RSFJ-së i cili nuk egzistotn defakto, po në këtë faqe në pasusini 9 nuk ipen sqarime se çfarë do të jetë roli i odës së veçantë brenda gjykatës supreme në veçanti agjensia ngatërrohet me autoritetin

dhe detyrat për ta administruar ndërmarrjen kur dihet se autoriteti nddryshon nga detyrat si nocion dhe si përmbajtje. Në pasusin 5 pika 4 të draftit parashifet rigjenerimi apo integrimi i ndërmarrjeve gjë që nuk mund të qëndron ngase regjenerimi dallon prej integritit edhe në përmbajtje edhe në kuptim juridik dhe ekonomik në neniin 6 të këtij drafti agjensia merrë kompetencat në tërsi të qeverisjes së ndërmarrjes duke eliminuar menagjerin të menagjoj në tërsi poashtu kam edhe shumë vërejtje që u prezentuan këtu në faqen 8 neni 4 pika 4 përckatohet shitjas e aksionit, shitjas e cila mund ti bëhet çdo kujt dhe çdo personi që dëshiron por jo edhe punëtorit të ndërmarrjes, mendoj se duke u mbështetur në vërejtjet që i dëgjuam këtu , si dhe velrismet e ekspertëve që i kemi ndëgjuar pranimi i rregullores për formimin e Agjensisë së Mirëbesimit, në radhë të parë është në dëm të punëtorit, të cilët me djerësn e tyre, mundin e madh krijojnë ndërmarrjet e të cilat tani brenda natës mund ti privatizohen tjetërsohen nga ata që nuk kan krijuara asgjë personalisht mendoj se privatizimi duhet përkrah por kjo rregullore me vërejtjet plotësiomet dhe sygjerimet të kthehet në rishqyrtim plotësim dhe ndryshim, Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, për fjalë është paraqitur deputeti Bislim Hoti, dhe lus sekretarin që të marrë fletëparaqitjet për diskutim.

#### **Z. BISLIM HOTI ,**

Të nderuar kolegë deputetë, e nderuara Kryesi, të nderuar ministra si dhe mysafirë nga lartë që e përcillni s eancën e sotshme, kur kemi të bëjmë me agjensinë e mirëbesimit kosovar e kryesisht zhvillimit ekonomik nëpërmjet privatizimit atëherë unë nuk do ta shoh një arsye duke e pasur parasysh kushtet që i ofron administrata e UNMIK-ut nuk dua të jemë shumë i gjatë pasi që diskutuesit më lartë i ceken problemet që po na kanosen për zhvillimin ekonomik, atëherë une dua ta bëjnë një kërkesë e cila ka qen dashtë të prezentohete sot këtu në Parlament nga prodhuesit e materialit ndërtimor, nga argjila këtu në Kosovë e cila kërkes ju ka drejtuar kryesisë së Kuvendit, kryetarit kryeministrit z. Shtajner, po me sa duket nuk është marrë parasysh, atëherë kur kemi të bëjmë me prodhuesit e materialit ndërtimor nga argjila në Kosovë shihet qartë, z. Hoti

ti përmbahemi tematikës, në rend dite është diçka tjetër keni konsiderat, mund ta shtrojmë më vonë në të ndryshme apo është një pikë tjetër, ju lutem, po atëherë nuk më mundësohet, jo, jo diçka tjetër është në debat ju lutem, po i them edhe nja dy tri fjalë, po i them, e kam parasysh çështjen e akcizës e cila është njerrë nga administrata e unmikut, kjo akciz e cila është nxjerrë nga administrata e UNMIK-ut nuk mundëson zhvillimin ekonomik por vetëm që ne si parlamentar duhet t'i dhurojmë këto indusri të materialeve ndërtimore, dhe të tjera që tju dërgojmë një dry dhe ti mbyllim ato, p.sh. një cilternë e ndryshuar nga ato, z. Hoti ju lutem do ta vëjmë në një pikë të rendit të ditës një herë tjetër ju lus,

**Z. FATMIR SEJDIU**, e ka fjalën z. Me syza pastaj zotëriu tjetër Xhevdet Neziri, pastaj le të përgaditet Slllobodan Bjeliq,

#### **Z. XHEVDET NEZIRI,**

Të nderuar anëtar të kryesisë, Itë nderuar deputet, unë jam Xhevdet Neziri nga inisiativa e re demokratike e Kosovës, do të ndalem nga agjensioni i mirëbesimit Kosovar do të jemë shumë i shkurtër do të kisha me u ndal vetëm në atë se a do të jetë agjensioni i privatizimit apo i komercializimit dhe z. Kryeministër e përckatoi shpejtësinë dhe Kosova ashtu, ashtu është e rrënguar në asëektin ekonomik due e marrë për bazë se në ish Jugosllavinë ishte si rajon më i pazhvilluar, dhe duke e marrë për bazë regjimin serb që e shkatërroi ekonominë kosovare, duke i marrë për bazë 12 vitet që skishim ekonomi fare dhe tani themi që gjysma e ndërmarrjeve janë të amortizuara jo fizikisht por edhe moralisht atëherë shpejtësia është një prej çështjeve kryesore ku duhet ti jepet vizë e gjelbërt, mirpo ajo vizp e gjelbërt atij agjensioni, nuk duhet të bëhen gabime për arsye se nëse fillohet me komercializim, atëherë ekonomia kosovare as që do të ekzistojnë, kështu që nëse bëhen gabime në ekonomi, atëherë do të kemi një perspektiv të zymtë në sfera tjera të shoqërisë kosovare, Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, për fjalë është paraqitur deputeti Slllobodan Bjeliq, le të përgaditete deputeti Sahit Krasniqi,

## **SLLOBODAN BJELIĆ,**

Gospodine predsedavajući, poštovani članovi Predsedništva Skupštine Pokrajine i poštovani članovi Parlamenta, poštovani poštovani članovi Vlade, z. Fatmir, ju lus z. Bjelić, është Kuvendi i Kosovës do të keni kujdes në termet zyrtare që Kosova është në këtë fazë të zhvillimit të saj. Ja se danas javljam u vidu jedne predstavke da tako kažem ili primedbe, cenim napore Komisije administrativne misije Ujedinjenih nacija na Vladu na ovom nacrtu uredbe broj 2002/20, od 11 juna 2002 i o osnivanju agencije za upravljanje preduzećama na Kosovu. Što se tiče ovog materijala, materijal smo dobili danas pre početka Skupštine neposredno ja u ime ove komisije a tu delim i mišljenje i prethodnih diskutanata. U vezi sa ovom tačkom dnevnog reda, molgo da izjavim da mi nismo blagovremeno dobili materijal i da i taj materijal nije prošao Komisiju za finansije, odnosno ekonomije. Predpostavljam da u ovom tekstu ima dosta materijala koji se tiče rada u ovoj komisiji i zato i današnji sastanak na ovoj temu razumem kao raspravu, ali bi zamolio za izjašnjavanje da se eventualno odložu tek kada budu pristigli svi stavovi sa svih komisija, i ujednom i primedba da se ovakvi materijali odmah proporuče i članovima Skupštine i predstavjućim i odgovarajućim komisijama. Hvala

**Z. FATMIR SEJDIU**, ju falëminderit, për fjalë është paraqitur deputeti, Sahit Krasniqi, le të përgaditet deputeti Gani Prekopuca,

## **Z. SAHIT KRASNIQI,**

E nderuara Kryesi, të nderuar kolegë. Dokumentin që sot po e diskutojmë mendoj se është i një rëndësie të veçantë, mirpo kam mendime të mija se e kemi marrë me një kohël shumë të vonuar dhe që mendoj se është dashur t'i kushtohet një kohë shumë më e gjatë për diskutim dhe për analizë nalilzë, meqë kryeministri i dha disa plotësime të cilat nuk i kemi me shkrim dhe tash mund të ngatrrohen ose mund të përsëriten disa nga vërejtjet tona dhe që në fillim u tha se diskutimet tona mund të jenë të frytshme por se di se sa mund të jenë të efektshme ose mund ta rregullojnë këtë projektregullore ,unë në

mundësitë e mia sa pata mundësi ta analizojë këtë projektregullore, i kam disa vërejtje, paraprakisht jam për formimin e Agjensionit dhe dhe ne e mbështesim privatizimin pa hezitim, mirëpo gjithsesi janë edhe disa vërejtje:

1. Që drafti i shkruar është në disproporcion me kohën e përpilimit dhe kohën kur mendohet të implementohet.
2. Pasi që është formuar në kohën kur Kosova nuk ka pasur institucione siq sështë parlamenti dhe Qeverija dhe për këtë arsye në asnjë vend të kësaj të implementohet ndikimi projektregulloreje nuk përmenden këto dy organe ,
3. Në kohën kur edhe me të madhe flitet që të bëhet transformimi i përgjegjësive nga ato të UNMIK-ut në ato kosovare në këtë draft nuk është asnjël e vetme fjalë.
4. Që në këtë draft të implementohet ndikimi dhe përgjegjësia e institucioneve tona legjitime pra Qeverisë dhe Parlamentit,
5. Në përbërje të bordit siq është përpiluar numerikisht mendoj se është numër i vogël dhe duhet të jetë numri më i madh e vendorëve.
6. Mendoj se në përbërje të bordit gjithsesi duhet të përfshihet një përfaqësues i komunave kur bëhet fjalë për ndërmarrjet e komunave përkatëse, pastaj si qështje tjetër si shumë e rëndësishme është edhe fondet krijimi dhe efektiviteti i tyre, agjensia mban fondin në gjyrollogari tësaj, këto fonde mbesin të ngrira, vërejtja ime është, pse nuk krijohet fondi i privatizimit si institucion i veçantë ose këto mjete të derdhen në buxhetin e Kosovës por edhe pas përfundimit të kontesteve që mendohet të mundëshme që do të jenë nuk është i përckatuar fati se çka do të ndodhp me këto mjete . Edhe në këtë agjension nuk është tejkalluar moskuptimi dhe trajtimi adekuat i pronës shoqërore si diçka të paqartë pronari i së cilës nuk dihet, prandaj duhet të konstatohete nëse mbi këto baza mendohet të fillohet privatizimi, është gati e pamundur të ndërtohen modele të suksesshme. Mendoj se shoqëria kosovare është burimisht pronare e ndërmarrjeve shoqërore dhe mbi këtë bazë duhet të krijohet dhe të menagjohet fondi shsoqëror i privatizimit në Kosovë, ky fond në bazë të vendimeve të kuvendit të Kosovës në bashkëpunim m epërfaqësuesin special sekretarit të përgjithshëm të kombeve të bashkuara do

të duhet tu përgjigjet disa nevojave imediate që do të dalin nga procesi i privatizimit, do të thotë krijimi i vendeve të punës asistencës sociale rikualifikimi i punëtorëve, fondi i pensionistëve investimet në infrastrukturë, janë edhe disa vërejtje të tjera por duke e pasur parasysh edhe ..... unë mendoj se kjo rregullore duhet të përmirësohet. Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, për fjalë është paraqitur deputeti Gani Prekopuca dhe le të përgaditet deputeti Muhamet Kelmendi.

### **Z. GANI PREKOPUCA ,**

Delegat të nderuar, ju e dini që provatizimin e keni lypur qysh pas luftës, kosovarët, sidomos subjektet ekonomike e keni vlersu se pa privatizim e keni vlersu se pa privatizim nuk ka vazhdim të jetës në Kosovë. Po çudi po bëj në veti për arse se është dashë që dikush të jep një model të tillë të privatizimit kosovar, të jetë produkt kosovar, sidomos Qeverija ose Kuvendi, është dashtë të jap një model të vetin i cili mendon se është i përshtatshëm për kushtet ekonomike të Kosovës, me qëlluar nuk ke kemi bërë këtë e kemi tash modelin e gatshëm, por edhe ky model mendoj, përveq atyre që i than kolegët nuk do të jetë i sukseshëm nëse nuk caktohet dinamika apo shpejtësia që e tha kryeministri për ekonomi dhe fionanca z Sadriu, nëse nuk mirren parasysh menjëherë që të formohet oda e veçantë pranë gjykatës Supreme të Kosovël, nëse nuk nxirret rregullorja për privatizimin e tokës, nëse nuk nxiret rregullorja mbi letrat me vlerë, nëse nuk nxirret rregullorja për inkurajimin e investitorëve me adaptimin e sistemit fiskal, krijimin e kushteve më të volitshme për kreditim , këto rregullore mendoj se duhet të caktohet qysh tash dinamika e nxjerrjes së tyre, nuk besoj se mund të ketë sukses edhe ky model i tillë, i cili deri më tash me sa njihem prej letrave nuk ka dikun të ngjajshëm në botë.

Prap po them, kritika ime është, pse nuk e kemi karshi këtij modeli, modelin tonë kosovar, kaq.

**Z. FATMIR SEJDIU**, Fjalën e ka deputeti Muhamet Kelmendi, është deputeti i fundit që ka kërkuar fjalën, ska tjerë.

**Z. MUHAMET KELMENDI,**

Zonja dhe zotërijë, unë do të mbështetem në një çështje për të cilën kryesuesi në fillim të seancës tha se mund të diskutojmë, por në fund skemi të drejtë të ndalemi të vendosim, ti shprehim mendimet si Kuvend dhe ti themi dikujna përfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm dhe të tjerëve të cilët e kanë nxjerrë këtë vendim që ky është vendim i kosovarëve, i Kuvendit të Kosovës dhe ne me këtë vendim të cilin e kemi nxjerrë në Kuvendin e Kosovës, kërkojmë nga përfaqësuesi special, nga UNMIK-u që është këtu i vendosur të ecim në të kundërtën Kuvendi nuk ..... dhe nuk është ai që e përkrah iniciativën e tillë, e përkrah iden e tillë dhe e përkrah rregulloren e tillë, në qoftë se vetëm do të diskutojmë si deri më tash dhe kryesia e kuvendit i merr këto vërejtje dhe i dërgon mëtutje atëherë ne mbesim në një situatë të tillë ku përfaqësuesi i sekretarit të përgjithshëm z. Shtajner me këshilltarët e vet do të kjo vlen. Kjo nuk vlen dashit veproni, mos veproni është çështje e juaj tamam siç thotë populli ta qon mallin si në këshilli në tranzicion i Kosovës e i cili ka vepruar tri vjet kur i diskutonin çështjet dhe në fund ishte 0 me 0 dhe bëhëj ashtu siç ishte propozuar prandaj duhet të jemi të qartë mendoj unë që kryesia duhet këtë çështje ta shtrojë në kontekst të këtillë të diskutohet, të qartësohet faktori ndërkombëtar këtu që ky është vendimi i kryesisë, ky është vendim i organeve të Kosovës dhe me këto vendime të cilat ne i kemi ke përkrahjen tonë, ke bashkëpunimin tonë dhe së bashku mund të hecim në rrugën e privatizimit, ose të krijimit të agjensisë vërejtja ime e dytë është e drejtuar kryesisht në atë faktin se kjo rregullore ose këtë draft ose këtë projekt si ta quajm unë si deputet e kam marrë sot. Ndoshta partitë e mëdha të organizuara janë të organizuara më mirë, ndoshta partitë e mëdha janë të organizuara më mirë dhe kanë grupe parlamentare të organizuara më mirë e kanë marrë më heret gjëja që u pa edhe sot këtu edhe kanë pasë mundësi me i shpreh mendimet por unë e shof jo të rrugës punë shumë të dobët të sekretarisë dhe të sekretarit i cili sot për fat të keq nuk është këtu përfaqësuesi i dërguar nga UNMIK-su i cili nuk e shef të rrugës këtë fakt kaq të rëndësishëm, këtë draft kaq të rëndësishëm, të

ja u sjell deputetëve së paku 1 javë më heret në mënyrë që deputetët ta analizojnë, e aq më keq kur as propozimet e Qeverisë nuk janë dhënë me kohë krahas draftit të tillë dhe asnjë komision deri më tash nuk e ka dhanë me shkrimi, nuk mundt të shofë një rrugë të mirë dhe asnjë Parlament z. Kryesues, nuk punon në formë të tillë të sjell një draft të tillë i cili ka rëndësi aq të madhe për privatizim, për hapjen e vendeve të reja të punës, mos ta kemi mendimin e Qeverisë me kohë dhe mos ti kemi mendimet e komisioneve në mënyrë që në kompetencat ti diskutojmë këtu dhe të vendosim për të ardhmen e ekonomisë së Kosovës është lehtë të hemi është në rregull dhe nuk është në rregull dhe pastaj kur krijohen problemet kur krijohet papunësia me 80, 90% themi qfarë vepruam dhe ku ishim, prandaj kërkoj dhe lus kryesinë që në këto drejtime të punohet dhe natyrisht të thirrë një mbledhje tjetër, seancë tjetër ose vazhdim i kësaj seance për javën e ardhshme dhe të jap kërkesa ose të kërkoj nga komisioni që brenda kësaj jave të shqyrtojnë këte dhe natyrisht javën e ardhshme të vijë, privatizimi ka zgjatur qe 3 vite nuk e kemi bërë këtë, pse pse zgjatë edhe 10 ditë me diskutue dhe me qenë të qartë nuk është fundi i botës dhe do të jetë përkundrazi një punë shumë e mirë qëdo ti ndihmojë procesit të tillë, proces për të cilin ne kemi vepruar dhe do të veprojmë, sepse e dijmë se bazë e zhvillimit ekonomik është privatizimi po jo vetëm në formën e tillë, sepse kjo është vetëm ana juridike dhe procedurale dhe asgjë tjetër dhe mbështetje e kompetencave në kuadër të një faktori i cili për mendimin tim as nuk e ka marrë anën historike të Kosovës, as mënyrën se si janë krijuar ato ndërmarrje shoqërore dhe as forma të tjera të cilat ka kaluar shoqëria kosovare në këto 40 vjetët e fundit qëka krijuar këtë pasuri dhe ne tani shumë leht mund të themi e bëjmë këtë dhe pastaj qytetarët tanë punëtorët tanë dhe ata që kan kontribuar, populli i Kosovës kërkon përgjegjësi nga Kuvendi, sepse këtij Kuvendi ja ka dhan votën dhe ne jemi përgjegjës para tyre. Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, dëshiron dikush tjetër fjalën nëse jo atëherë do të përpiqemi që në konsultime me anëtarë të kryesisë të Kuvendit të përmbullim këtë çështje, mendoj se debati ishte jashtëzakonisht i frytshëm, mendoj se vërejtjet që u dhan nga deputetët janë të qëndrueshme, mendoj se kemi të bëjmë me një çështje jashtëzakonisht të vlerës së madhe dhe që ka të bëjë me një transformim të plotë ta quajmë të sistemit ekonomik

dhe të marrëdhënive juridike pronësore në Kosovë dhe me që kemi parasysh edhe një vistër të angazhimeve sidomos të ekzekutivit të Qeverisë së Kosovës dhe të komunikimeve të saj në relacionet e deritashme për procesin e mbarshtrimit të këtij dokumenti u në kujtoj se këto vërejtje e kanë vlerën e tyre dhe mund të sublimohen ndoshta në një analizë të re edhe nga ana e komisioneve të tjera, përkatësisht të ekonomisë dhe financave dhe komisionet e tjera që e shohin të udhës që të japin mendimet e tyre. Në ndërkohë, unë mendoj se duhet të marim të gjithë hapat e nevojshëm që në bashkëpunim me Qeverinë edhe në këtë fazë të këtij debati, këto vërejtje të juaj të si gojore poashtu edhe me shkrim që u dhan të përcillen në proces të analizimit të tyre në kuptimin e arritjes thjesht të një variante të përshtatshme të këtij dokumenti të rëndësishëm për ardhmërinë e Kosovës, a pajtoheni që kështu të përbyllem dhe në procesin e mëtejshëm dhe në procesin e mëtutjeshëm të mirremit vesh si do të debatojmë, ndoshta, të shohim sipas asaj që do të reflektoj edhe nga puna e komisioneve të vazhdojmë në një seancë tjetër, por me një dinamikë më të shpejtuar:

Kush është për: Ju falënderit

Kush është kundër: zoti Haliti dëshiron, kush është kundër, që ka të drejtë.

## **Z. XHAVIT HALITI,**

Të nderuar kolegë nga konstituimi i Parlamentit të Kosovës, 6 muaj shfaqje dramatike, 6 muaj ky Parlament nuk ka miratuar asnjë ligj, 6 muaj diskutime të kota jashtë kompetencave tona, mendoj se duhet të gjykojmë më drejtë dhe më mirë për problemet që po i ngrisin në parlament, kemi miratuar një Rezolutë e cila ka pasur jetëgjatësi 5 minuta, dhe askush nga deputetët e Parlamentit të Kosovës duke e përfshi edhe kryesinë nuk ka pa të udhës që të diskutoj pas shfuqizimit të kësaj Rezolutive nga përfaqësuesi special dhe ta analizojmë sinqerisht dhe seriozisht se a janë fajet në anën tonë që i ngrisin çështjet që nuk janë në kompetenca tona, apo janë fajet diku tjetër, çështja e rregullores së mirëbesimit është çështje e rezervuar këtë duhet ta dijmë të gjithë BSPPS, SE JANË BËRË SHUMËL BSPP-së UDP-ja dhe z. Shtajner sispas të gjitha gjasave z. Shtajner na ka lejuar ose për hirë tonin që të mos na ofendoj rënd, na ka lan sot që të

diskutojmë dhe kjo Rregullore do të nënshkruhet nga ai, ne mund të votojmë për me vazhdu diskutime për me ba mospajtime mund të organizojmë edhe seminare por duhet të kemi parasysh që nuk është çështje e këtij Parlamenti ose më mirë të themi se është çështje e rezervuar për z. Shtajner jo rregullore. Duhet të përcaktohem mendoj si deputet se a do të merremi me çështje të cilat na janë përcaktuar me Kornizën Kushtetuese apo do të kërkojmë në format e mundëshme të presionit politik të këtij Parlamenti dhe të qytetarëve të Kosovës, që të inicojnë procesin e ndryshimit të Kornizës Kushtetuese tani, o jemi me këtë Kornizë Kushtetuese me vepru o jemi me ndryshu, prandaj nuk është mirë ta mashtrojmë as vetveten as qytetarët që po vendosim për këtë farë lloj drafti të Rregullores nën 1 dhe çështje tjetër dhe dobësi shumë e madhe e këtij Parlamenti dhe në veçanti e kryesisë së Parlamentit është refuzimi kategorik i pa justifikueshëm dhe i paarsyeshëm i kryesisë së këtij Parlamenti që Qeveria e Kosovës të bëjë betimin para Parlamentit të Kosovës, para kujt duhet të jap llogari Qeveria e Kosovës, dhe pse ta qesim Qeverinë tonë, Qeverinë që e kemi miratu në këtë Parlament në pozit të vështirë, që u detyruar dhe të japi betimin vetëm para Përfaqësuesit Special z. Shtajner. Për këto çështje mendoj se nuk guxojmë të heshtim, nuk guxojmë ti kalojmë ashtu formalisht pa e justifikuar ashtu veten e vet qoftë kryesia..... Qeveria e parë demokratike e zgjedhur të bëjë betimin para deputetëve të sajë, kaq, Kosovës si rrugë ekzekutive e dyta

**Z. FATMIR SEJDIU**, vetëm një sqarim të shkurtër pa nevojë që të shkojmë në debat të mëtejshëm, mendoj se ne morëm një qëndrim që këto vërejtje të përcillen në rrugë përmes Qeverisë së Kosovës si ekzekutive, e dyta sigurisht që zoti Haliti do të na ndihmonte edhe më shumë po qe se do të ishte edhe në seancën e kaluar të Kryesisë së Kuvendit kaë qen sigurisht me mungesë objektive dhe ne jemi në këtë pozicion të tashëm nuk do të dëshrojmë që Kuvendi sigurisht të vazhdoj me debate të tjera në qoftë se ju e shihni të udhës.

**Z. FATMIR SEJDIU, pika e dytë e rendit të ditës**, është emërimi i anëtarëve të rinj të komisioneve të Kuvendit, një informim të shkurtër rreth kësaj. Ju e dini se Kryesia e Kuvendit në një seancë të mëhershme të sajë edhe në seancën e Kuvendit ka

dhanë informim në bazë të një kërkesë se komisionet e Kuvendit në përbërje të tyre prej 9 anëtarësh për shkak të nevojës së prezencës të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në shumsinë e komisioneve, pra në tërësinë e tyre, në variantat sipas afiniteteve të jenë pjesëmarrës edhe në komisione, për atë arsye ka qenë që të bëhet zgjerimi i këtyre komisioneve në 11 anëtarë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të miratuara mheret nga Kryesia e Kuvendit, kërkesë e grupeve parlamentare që të bëjnë plotësimin e komisioneve deri tash kanë bërë plotësime të gjitha grupet parlamentare, përkatësisht edhe deputetët të cilët s'kanë qenë të anëtarësuar për distribuimin e tyre në përjashtim të Partisë Demokratike të Kosovës dhe i lus sigurisht që në afatin më të shkurtër, në ndërkohë të përcjellin edhe emrat e deputetëve që duhet të jenë anëtarë të këtyre komisioneve. Kaq lidhur me këtë pikë.

#### **Z. FATMIR LIMAJ ,**

E nderuara Kryesi të nderuar deputetë. Desha të lidhem me çështjen që ju e ngritët z kryesues se vëret janë disa vende që Partia Demokratike nuk i ka plotësuar dhe po në seancat e kaluara ne jemi marrë vesh dhe kemi bërë kërkesë zyrtare që të zyrtarizohen deputetët e rinjë, pasi që një kryeministër dhe dy ministra e kanë dorëzuar manatin e tyre dhe ko punë mendoj se është një zhagjitje nga vetë Kryesia e Parlamentit dhe sot kërkoj që të bëhet zyrtarizimi i deputetëve të rinjë dhe që pastaj t'i plotësojnë vendet e tyre nëpër komisionet përkatëse. Problemi qëndron në atë se pas tërheqjes së ministrave dhe kryeministrit praktikisht Partisë demokratike të Kosovës i mungojnë tre përfaqësues në komisionet përkatëse. Shpresoj që kjo çështje do të merr fund dhe do të zyrtarizohen edhe tre deputetët e rinjë të Partisë Demokratike dhe që më pastaj të angazhohen në komisione përkatëse. **Fatmir Sejdiu**, ju lutem unë vetëm një skjarim të pikës së parës, Kryesia e Kuvendit ka shtruar këtë çështje dhe është në proces e sipër në aspektin zyrtar që të bëhet plotësimi dhe sigurisht mund të jetë pengesë edhe për ju kjo pengesë e arsyeshme, dhe besoj se do ta bëjmë në afatin më të shkurtër bashkë me sekretarin e Kuvendit. Të ndryshme, nëse keni mund të vazhdoni ju lutem.

Fatmir Limaj, Desha t'i ngris disa ështëje që mendoj se janë në interes të funksionimit të Parlamentit të Kosovës dhe të punës sonë. Unë mendoj se ende mbledhjet e Kuvendit të Kosovës janë të papërgatitura dhe konsideroj se ne ende kemi probleme të tilla. Deputetët e Parlamentit të Kosovës vijnë në seanca të papërgatitura paraprakisht. Unë i evidentoj lëshimet që i bënë administrata e Parlamentit. Disa nga deputetët thanë që edhe rendi i ditës dhe Rregullorja ka ardhur me vonesë. Unë mund të them lirisht edhe deputetëve se ne si parti e madhe e Parlamentit nga Partija Demokratike e Kosovës edhe rendi i ditës edhe disa materiale të cunguara kanë ardhur me vonesë, do të thotë Parlamenti i Kosovës vazhdom me seanca jo mirë të përgatitura dhe prandaj dalin nganjëherë pozita qesharake. Kisha dashur që Kryesia e Kuvendit të Kosovës definitivisht ta shtrojë si rend dite edhe në vetë kryesinë e tyre, por edhe në Parlament, funksionimin e Parlamentit të Kosovës. Dëshiroj që Kryesia e Parlamentit të Kosovës t'i procedojë kërkesat e grupeve parlamentare për të futur pika të rendit të ditës në seanca të ardhshme. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike që dy javë ka dërguar një kërkesë që në rend dite në seancat e ardhshme të futet mosfunksionimi i Kuvendit i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe në tërësi Parlamentit. Çështja e nxjerrjes së Rregullores dhe plotësimi i Rregullores së punës së Kuvendit ndërsa ne funksionojmë me një rregullore që ende nuk është aprovuar në Parlament. Momenti praktik po tregon se ka nevojë ajo rregullore të ndryshohet, të plotësohet dhe t'i përshtatet punës së Kuvendit, të jetë sa më praktikë dhe sa më efektiv ky Parlament.

Shpresoj se Kryesia e këtij Kuvendi do t'i marrë definitivisht parasysh. Gjithashtu Kryesia e Kuvendit është e obliguar, çështjet të cilat i ngrisin deputetët në mbledhjen e pastajme ose me shkrim t'i njoftojnë mbi ato pika ose pyetje ose çështje që kanë ngritur deputetët e caktuar, dhe mos të mbetet si retorik kjo që tha Muhamedi sikur në Këshillin Tranzitor s e e dhe në Këshillin tranzitor janë ngritur çështje e pastaj nuk janë dhënë përgjigje, por ai më shumë ka qenë organ konsultativ. Gjithashtu konsideroj që anëtarët e Kryesisë së Kuvendit ta shohin Kornizën Kushtetuese dhe atë rregullore të përkohshme dhe të veprojnë në bazë të kompetencave të tyre. Me çfarë të drejte Kryesia e Kuvendit të Kosovës thotë e ka refuzuar betimin e Qeverisë para Parlamentit të Kosovës dhe në qoftë se kytij refuzimi iu ka bashkangjitur edhe anëtari i Kryesisë nga Partija Demokratike e Kosovës dhe atëherë unë këtu them publikisht se ka bërë jasht grupit

parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe si i tillë ne nuk e pranojmë sepse nuk është në kompetencën e tyre Qeveria e votuar në Parlamentin e Kosovës duhet të jap atë betim si do që të jetë para këtij organi. Ne nuk e vëjmë në pyetje ose në dilemë pse është dhënë para z. Shtajner, por mendoj se duhet të jipet edhe para Parlamentit të Kosovës, jo vetëm Qeveria por edhe kryetari i Kosovës dhe kërkojmë nga ne emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike që Kryesia e Parlamentit zyrtarisht të kërkojë nga Kryetari i Kosovës nga Qeveria që në një seancë të jashtëzakonshme ta bëjë betimin para këtij organi më të lartë të Kosovës, për ndryshe pse të funksionoj ky organ. Çështja tjetër që desha ta ngris sigurisht keni ardhur në Parlament keni parë nëna nga Gjakova të cilat kërkojnë fëmijtë e tyre, të afërmit e tyre. Kërkoj nga Kryesia e Kuvendit që ta bëjë një takim me delegacionin e të zhdukurëve që janë para ndërtesës së Parlamentit dhe definitivisht të vendoset një komision, i cili do të ketë përkujdesje të vazhdueshme rreth shqetësimeve dhe zbulimit të fatit të të zhdukurëve në Kosovë.

Shpresoj që Kryesia e Kuvendit edhe këtë do ta bëjë, sepse është e domosdoshme. Ne, në kohën kur po bisedojmë këtu ato janë para ndërtesës së Parlamentit. Vërtet është e padrejtë, e pakuptimtë dhe shpresoj që edhe Kryesia e Kuvendit dhe organet tjera të Kosovës do të kenë një përkujdesje të veçantë. Më fal z. kryesues ndoshta e zgjata pak. Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, kam disa çështje paraprake, nën të ndryshme, po përkisht për komisionet flas rreth të parës, ajo pikë e rendit të ditës kaloi. Ne kemi pasur një debat në Kryesi ekziston edhe kërkesa e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të thotë numri i përgjithshëm i deputetëve që i kanë edhe në koalicion edhe si parti, çështja nën të ndryshme dua t'ju informojë dhe këtë çështje që e ngriti deputeti i Partisë Demokratike z. Fatmir Limaj, Kryesia e Kuvendit duke e pasur parasysh propozimin e komisionit për legjislacion ka propozuar një komision, ka marrë vendim për harimin e rregullores së Kuvendit, anëtarët e komisioneve i keni në dokumentet e sotshme është anëtari për legjislacion z. Arsim Bajrami, z. Muhamet Kelmendi, z. Keniq një nga sekretaria dhe unë. Në ndërkohë, besoj se do të kemi nevojë nga sekretaria dhe nga stafi profesional të inkorporojmë edhe dikënë tjetër. Unë mendoj se Kuvendi pajtohet me këtë qëndrim. Ju falënderit. A ka kush kundër z. Xhavit Haliti, ju lutem unë do ti

lutështa të gjithë të tjerët pse janë për z. Haliti keni në konsideratë ju jeni shprehur kundër qëndrimiin e tuaj dhe po e ndihmuat e shifni në votim dhe ska të keqe kurgja. Muhamet po e kaluam atë pikë o burrë, doni edhe njëherë ta merrni fjalën.

## **Z. MUHAMET KELMENDI,**

**Z. FATMIR** e tha shumë drejt dhe shumë çart zonja dhe zotërinjt emrat e njerëzve të humbur dhe natyrisht Kryesia ka për detyrë të shkojë te sheh, të kontaktojë edhe të del këtu. Ajo që unë dola këtu nuk është kjo, se kjo është dashurr nga kryesuesi dhe Kryesia të kryhet në mënyrë zyrtare pa e shprehur këtë qëndrim. Këtu është kjo se ne kemi kërkuar këtu në këtë Kuvend që në tri seancat paraprake që t'i formojmë dhe të organizojmë edhe dy komisione dhe sot flasimi për plotësimin e komisioneve ekzistuese, nuk flasim për formimin e dy komisioneve për të cilat është paraqitur kërkesa në mënyrë zyrtare në këtë Kuvend. Komisioni i parë është pikërisht për të humburit dhe unë kam propozuar disa herë dhe kam theksuar dhe kam obligim moral për magjistër Ukshin Hotin i cili ka qenë kryetar i partisë sonë ku jam edhe unë aktualisht dhe Kryesia nuk e ka parë të arsyeshme. Ende të jap një sqarim po ose jo, formohet ose nuk formohet ky komision dhe unë mendoj se është e domosdoshme që të formohet ky komision. Arsyet i kam thënë edhe më herët dhe komisioni i dytë për të cilin unë mendoj se është e domosdoshme sot në këtu të votojmë dhe lus Kryesinë që për këto dy komisione të paraqet në votim, është çështja e Komisionit për mergatën edhe këtë kërkesë e kemi paraqitur në seancat e mëhershme dhe unë kam pritur që Kryesia sot kur të bëhet çështja e diskutimit për çështje të tilla për komisione do t'i paraqet edhe këto dy komisione të reja që do të formohen në mënyrë që ne të votojmë ose të shkojmë kah plotësimi i tyre si duhet, sepse mendoj që janë dy çështje jashtëzakonisht të rëndësishme në qoftë se z. kryesues keni kaluar në të ndryshme dhe unë do ti them dy çështje dhe s'kam nevojë të dalë më tutje.

E para është çështja e betimit. E shof shumë jo të rrugës që Qeverija e dalë nga ky Kuvend të mos kthehet për tu betuar dhe kryetari i Kosovës në këtë Kuvend dhe të shkoj diku tjetër, në bazë të cilave rregulla e keni refuzuar këtë çështje dhe në bazë të cilave rregulla Qeveria ka shkuar para z. Shtajner për t'u betuar. Unë shoh këtu shkelje

të dyanëshme, shkelje të Kuvendit, pse ka refuzuar një çështje të tillë dhe shoh shkelje të Qeverisë pse ka shkuar dhe është betuar para z. Shtajner. Ne e respektojmë dhe i dimë kompetencat e z. Shtajner, por Qeverinë e ka zgjedhur ky Kuvend dhe ky Kuvend është ai para të cilit duhet të jipet betimi si Qeveria dhe kryetari. Çështja e dytë e cila e lus Kryesinë për ta përcjell më tutje është, ne nuk e dimë fare se çka punohet nga ana e kryetarit të Kosovës, e respektojmë ja kemi dhënë votën, është mirë të dalë me një program të punës siç ka dalë Qeveria sepse është kryetar, figurë reprezentative e këtij vendi dhe të thotë këto, këto çështje brenda peridhës trivjeqare do t'i kryejë është detyrë mendoj se duhet të keni në konsideratë.

**Z. FATMIR SEJDIU,** Ju lutem të kemi konsideratë, ju japim fjalën me rend kam edhe disa çështje t'i shtroj e pastaj mund të inicohen edhe çështje tjera edhe pyetje drejtuar institucioneve të Kosovës edhe ekzekutivit edhe të gjithë të tjerëve. Nuk mund t'i ndalohet asnjël deputeti fjala, absolutisht por të kemi konsideratë në radhë.

Sipas materialeve që keni në informim në rregullt është çështja e formimit të komisioneve. Besoj se Kryesia në seancën e parë të ardhshme do të dalë me propozime konkrete dhe besoj se do t'i ketë parasysh këto kërkesa siq ka parasysh edhe siq ka kërkesa për ofrimin edhe të ndonjë komisioni tjetër të Kuvendit, por do ta shofim arsyeshmërinë e tyre dhe vendim final në Kuvend. Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe në bazë të ofertave dhe ndihmave që na kanë ofruar USAIDI dhe Asambleja Franceze kumton që në një fazë të ardhshme t'i hyjë rregullimit kompjuterik dhe ndërtimi të infrastrukursë së brendshme të sallës së Kuvendit, kësaj salle plenare sigurisht dhe të lokacioneve të tjera. Ne vetëm mund ta përshëndesim këtë qëllim. Sa i përkekt çështjeve të tjera që u shtruan, unë besoj se secili nga deputetët serish them se ka të drejtë të inicojë dhe të parashtojë dhe në bazë të procesit normal të punës ne do të shkojmë në rrjedhë. Në çështje të tjera nuk do të lëshohesha në polemikë për çfarë arsyesh është shtyr e çështja e betimit të Qeverisë dhe ne kemi konsideruar si Kryesia dhe ky është arsyetimi që është dhënë në Kryesi, se edhe Qeveria si dhe kryetari i Kosovës si dhe institucionet, por edhe deputetët kanë filluar punën që në fazën e parë të zgjedhjes së tyre dhe ka qenë një proces i rrugës zyrtare dhe mbi këtë bazë ne kemi kaluar në atë përgjegjësie pa nevojë që të kemi farë

kundërshtish apo ferkime të tjera të cilat mund të interpretohen në forma të ndryshme. Dëshiron dikush në të ndryshme. Urdhëroni z. deputet Halil Ahmeti,

**Z. HALIL AHMETI,**

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë. Më falni që po e përsëris, por dy çështje të ngritura më parë njëra për formimin e një komisioni për marrjen peng të vëllezërve dhe të fëmijëve dhe nënave tona, dhe nën dy, për çështjen e takimit të këtyre nënave të cilat u përmendën dhe janë para platosë së Kuvendit. Dëshiroj sot që të kemi një përgjigje konkrete. Ju lutem për këtë shqetësim dhe e kam obligim moral jo vetëm për këto nëna, por edhe në emër të të gjithë të tjerëve që janë të shqetësuar lidhur me këtë rast. Lus Kryesinë dhe njëherit me sa jam në dijeni edhe kërkesa që e ka kryeministri t'i takoj këto nëna, Ju falënderit,

**Z. FATMIR SEJDIU,** dëshiron dikush fjalë. Kam një radhë para vettes Deputeti Driton Lajqi, le të përgatitet Bujar Dugolli. I paraqitni me shkrim, ju lutem se s'mund sekretarija. Urdhoroni ju lutem.

**Z. DRITON LAJÇI,**

E nderuara Kryesi, të nderuar kolegë, të nderuar ministra. Kjo është çështje procedurale të cilën dua ta prezentoj. Ne biseduam për çështjen e Agjencionit kosovar të mirëbesimit, diskutuan të gjithë edhe profesionalistë edhe deputetë edhe Qeveria etj. Mirëpo unë mendoj se do të duhej të frymëzohen ato diskutime tona, tu jipet shpirti Parlamentit të tyre, a në formë konkluzioni, a në formë deklarate e ta mbajmë mend nesër se qfrë kemi diskutuar dhe ta dim se çfare kemi diskutuar. Desha të ndërlidhem me këtë që është çështja e procesverbalit. Parimisht me rregullat e udhëheqjes së mbledhjeve procesverbalet nga mbledhja e kaluar duhet të miratohen në mbledhjen e ardhshme. Ne kemi mbajtur disa mbledhje. Unë i kam bërë edhe disa procesverbalet dhe ato nuk janë propozuar që të miratohen këtu. Procesverbalet e mbledhjeve të kaluara. Kam një kërkesë e që ato profesionale të jenë profesionale të jenë të sakta, të jenë të qarta, dhe të jenë të shkruara

shqip, për shkak se ato janë të cinguar dhe nuk shprehin realitetin çfarë kemi dikutuar ne këtu , prandaj kërkoj nga Kryesia që të ketë në konsideratë këtë diskutim timin. Ju falënderit,

**Z. FATMIR SEJDIU**, Ju falënderit. Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli,

**Z. BUJAR DUGOLLI**,

Megjithatë pasi që s'mu dha fjala kur është në pyetje për komisionin tani po e paraqes atë shqetësimin tonë. Sipas formulës së re, çdo grup parlamentar ka të drejtë pjesëmarrje në çdo komision të Kuvendit dhe unë këtu nuk shoh në komisionin për interesat dhe të drejtat e komuniteteve asnjë deputet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ne kemi propozuar si subjekt politik z. Mahmut Bakallin, prandaj kërkoj që emri i tij të futet në këtë listë sepse është e drejtë jona dhe na është garantuar që mund të përfaqësojmë në çdo komision, kjo është një e dyta në të ndryshme grupi ynë parlamentar ka kërkuar edhe më heret për formimin e Komisionit për dëmet e luftës dhe çështjen e personave të zhdukur. Unë mendoj që sot duhet të merret inisiativa që të formohet ky komision dhe ai delegacion qo do të delë dhe të flas para nënave, barëm ta ketë një çështje të tillë që t'iu tregojë atyre që Kuvendi bëri diçka për ta. Sot, në këtë mbledhje njëkohësisht Kryesia e Kuvendit duhet ti jep një vërejtje z. Shtajner, i cili në takime thuaja të përjavshme apo të dyjavshme që po i bën me Qoviqin anjëherë nuk e ngriti këtë çështje. Mendoj se kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe shumë preokupuese për ne që duhet të bisedohet dhe t'i jipet përgjigje për këtë. Ju falëmindeerit,

**Z. FATMIR SEJDIU**, Ju falënderit, me radhë është deputeti Gani Prekopuca. Nuk është këtu. Deputeti Blerim Baruti,

**Z. BLERIM BARUTI**,

Faliminderit i nderuari kryesues, e nderuara Kryesi , të nderuar kolegë, kam disa çështje që t'i ngris për bashkëatdhetarët, rreth paraqitjes së dokumenteve të udhëtimit të cilës i

bëhet presion në mosmarrjen e dokumenteve të udhëtimit të vetë qytetarëve tanë të Kosovës që janë në mërgatë se si shkon puna që të pajisen me këto dokumente të udhëtimit. Ata interesohen në çdo kohë, pastaj është edhe një çështje tjetër e marrjes së doganave nga ana e pushtetit të Malit të Zi për bashkatdhetarët që vijnë nga mërgata . Mali i Zi doganon punëtorët tanë që vijnë nga mërgata me 30% doganë, ndërsa sipas marrëveshjes kemi kuptuar se është 3% për shkak të tranzitit në këtë shtet që kalohet. Ata e tejkalojnë atë normë në çfarë mënyre nuk e dinë as vet, mirëpo mirë është që të interesohemi dhe ky takim të bëhet në shtetin e Kosovës e jo në Malin e Zi. Çështja tjetër është një porosi për agjensionet e transportit ajror ngase tani janë ngritur çmimet enorme. Mirë kishte qenë që një porosi të shkojnë me një çmim sa më të arsyeshëm bile, bile linearisht me atë që ka qenë deri më tan. Këto janë tri çështje për të cilat kam porosi për t'i ngritur. Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU** . Mendoj se këto janë nga çështjet konkrete dhe sigurisht përfaqësuesit e Qeverisë këto do ti kenë parasysh dhe posaqërisht shërbimet publike nga çështjet që u shtruan dhe të dhe çështjet e tjera të transporteve të ekonomisë. Për fjalë është paraqitur deputeti Hajredin Kuqi.

#### **Z. HAJREDIN KUQI ,**

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë. Unë do t'i ngris disa çështje dhe në fillim dua ta falenderoj Kryesinë e Kuvendit që ka pasur parasysh propozimin tim paraprak që të kemi një pikë të rendit të ditës. Nën të ndryshme, do të ngris çështjen në radhë të parë që dëgjohen jashtë kompetencave të tyre. Nga kryesia e Kuvendit po edhe vet nga kryetari i Kuvendit dhe nga vetë Kuvendi, në radhë të parë ne e dijmë që për Agjensinë kosovare të Mirëbesimit kemi pasur delarime nga kryetari i Kuvendit i cili më vjen keq që s'është sot këtu dhe ato deklarime kanë qenë paksa emocionale dhe mund të them se deklaramet personale, po se kryetari i Kuvendit duhet të ketë kujdes ndaj këtyre deklarimeve. E dyta, mendoj se Kryesia e Kuvendit , po e përsëris atë që e thanë më heret për çështje të ndjeshme, siç është betimi dhe të tjerat nuk ka kompetencë që të vendos por duhet që ta bien në Kuvend çështjen dhe mbi bazën e vendimit duhet ta

prezentojë ate, dua ta prezentojë këtë se Kryesia e Kuvendit dhe vetë Kuvendi kanë mundësi dhe kanë kompetencë të përfaqësojnë ate qëfarë vendoset në Kuvend e jo ate se çfarë vetë mendojnë. Mendoj se kryeministri i Kosovës sot ka ardhur pa arsye këtu, e kisha lutë kryeministrin që të ruaj autoritetin e tij që të mos dikskutoj për çështjet të cilat nuk i takojnë dhe të jap një llogari se si e ka bërë betimin dhe para z. Shtajner dhe gjithësesi kryeministri të bëjë një kërkesë me shkrim që të jap betimin para Kuvendit të Kosovës. Çështje tjetër e keni vërejtë që edhe puna e Kuvendit të sotëm po edhe shpeshherë po vërehet se është si punë e seminareve. Unë jam kundër kategorik të seminareve që bëhen në objektet e Kuvendit, paramendoni në Kongresin Amerikan, në Bundestag të merr njerin që .....seminar. Mund të mabjmë seminare, po në vende dhe hapsira tjera. Kjo sallë që nga hyrja deri në dalje ka soleminitetin e vet. Unë deklarohe publikisht që për seminare nuk ka nevojë të më thërret sekretaria e Kuvendit. Asnjëherë deri në përfundimin e këtij mandati, e treta, mendoj se organizimi i mbledhjeve po bëhet shumë rrallë, përveç që bëhet rrallë bëhet edhe në mënyrë të papërgatitur dhe mendoj që nuk ngritën çështjet të cilat duhet të ngriten, këto çështje janë si rezultat i punës që bëhet shumë pak apo ndoshta fare në komisione, e them këtë me përgjegjësi ngase në komisionin për arsim, ajo vihet si rezultat i mungesës së punës, i mungesës së kushteve për punë, dhe mbi të gjitha i mungesës së rregulativës ligjore e cila do të shihet në raportin në mes të Kryesisë së Kuvendit dhe të Komisioneve. Mendoj se propozimet të cilat jipen këtu duhet të shqyrtohen nga ana e Kryesisë dhe të japin përgjigje pozitive ose negative, Unë personalisht kam dhënë disa propozime dhe asnjëherë deri më sot nuk më është kthyer përgjigja. Propozimi im një ndër të parat ka qenë që në ditë Kuvendi i Kosovës të diskutoj për çështjen e sigurisë në vend. Ky propozim ende nuk ka ardhur në Kryesi dhe nuk është shqyrtuar. Propozim tjetër ka qenë që kryeministri i Kosovës të raportoj mbi vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo më duket se si thotë një fjalë popullore boja, por si do që të jetë mendoj se propozimet e secilit deputet të Kuvendit të Kosovës duhet të merren në shqyrtim dhe arsyet pse pranohet apo nuk pranohet duhet të njohftohet ose përmes Kuvendit, ose me shkrim te deputeti përkatës, e kundërta e kësaj në qoftë se japim vetëm propozime dhe nuk shqyrtohen unë do ta kursej veten nga fjalët e kota. Ju falënderit.

Z. Fatmir Sejdiu, ju falënderit z. Kuqi, vetëm një koment të shkurtër ndihmesë, Mendoj se çështjet që u shtruan për punën e komisioneve dhe këto kanë arsyen e vetë. Deri më tash kemi qenë në një fazë të konsolidimit e cila ende nuk ka përfunduar në kuptim të përmbajtjes së brendshme apo tërësisë së komisioneve janë edhe nevojat objektive pa nevojë të arsyetimit që e vështësojnë këtë. Sa i përket çështjes së seminareve dhe çështjeve të tjera ka qenë një qëndrim që vërtet në këtë sallë plenare të mos lejohet mundësia, e vetmja gjë është vetëm me seancat apo me seminarët që kanë të bëjnë me ndihmat të bashkëpunimit me parlamentet tjera që kanë të bëjmë me deputetët, jo me asocione të tjera.

Për fjalë është paraqitur z. Remzije Nimani e më pastaj Sabit Rrustemi. Urdhëroni ju lutem.

#### **Z. REMZIJE NIMANI,**

E nderuara Kryesi, i nderuari kryesues i mbledhjes, të nderuar deputetë është mirë që në kuadër të pikës „të ndryshme,, të diskutojmë për kërkesat e nënave tona të cilat janë të brengosura , për fëmijët e zhdukur dhe janë të mllefosura për mospranimin si të them prej kryetarit e deri te institucionet e tjera, nuk janë të kënaqura me pranimin e tyre që ato ta shprehin brengën e vetë, ne kemi për detyrë që ta ngrisin zërin në përkujdesjen e këtyre nënave për ndriqimin e fatit të të zhdukurve dhe të humburve të tyre. Lidhur me këtë në Kuvend na ka arritur edhe një propozim nga deputeti Ramadan Kelmendi që është mirë të shqyrtohet pak ma, detajisht një propozim ligj për fatin e shpalljen e të të zhdukurve dhe të të humburëve Ky propozim-ligj duhet të shqyrtohet sipoas mendimit tim dhe pak të zbuten zemrat e nënave që presin jashtë. Kërkoj që sot të formohet një komision që të bisedohet me gratë që janë para Parlamentit tonë. Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, Ju falënderit deputeti Sabit Rrustemi,

**Z. SABIT RRUSTEMI**,

Kryesi e punës të nderuar deputetë edhe unë do t'i shtrojë ri çështje nën të ndryshme në mënyrë që kjo pikë të bëhet më interesante tash e tutje. E para sa i përket betimit të Qeverisë dhe të kryetarit të Kosovës, unë mendoj që këtë është dashur ta kërkojmë me 4 mars atë ditë që është votuar, e jo tash pas tre muajsh e sa deh unë konsideroj që tash për punë është e panevojshme që ata të betohen, a ka qenë shumë e rëndësishme që atë ta bëjnë me 4 mars. Çështja e dytë, unë unë kam përmend edhe ma heret dhe tash po e përmend nuk do të shtrojë më çështjen e komisioneve, sepse si duket këtu aq sa do të ketë deputetë këtu aq do të ketë edhe propozime për komisionet për randaj kjo është jashtëzakonisht e tepërt, një çështje tjetër që dua ta ngri, ne duhet ta qyrtësojmë edhe pozitën e ministrave të cilët janë edhe deputetë. Po më vjen keq që tash nuk janë të gjithë këtu që u qojshin pak më heret ata duhet të definohen ose ministra ose deputetë. Unë po e përmend një shembull, nëpër kuvendet e komunale asnjë këshilltar komunal në Kosovë nuk është lejuar që të jetë edhe drejtor i një drejtorie, si dhe këshilltar komunal, por është dashtë të zgjedhi ose drejtor, ose këshilltar komunal. Prandaj konsideroj që edhe në qarqet e ministrave kjo duhet të vijë në shprehje, prandaj lus që këto ti keni në konsideratë. Ju falënderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, ju falënderit deputeti Himo Kandiç,

**Z. HIMO KANDIQ**,

Poštovano predsedništvo, poštovane kolege, poštovani ministri, prijete nam bilo više sada smo ostali na jednoga, samo sam hteo da koristim prilliku ovoga puta i da kažem da podržavam formiranje komisije nestalih lica, predložio bih da u ovoj komisiji obavezno da uđe i predstavnik naše zajednice 1 jer vama sigurno poznato da se radi o jednoj dobrom broju nekoliko desetina ovaj osoba za vrijeme rata i posle rata da je

sudbina o jednom djelu bošnjaka i dan danas se ne zna stoga razloga rasmislmo i u toj komisiji ude i predstavnik naše zajednice , hvala,

**Z. FATMIR SEJDIU**, deputeti Lirak Çela,

**Z. LIRAK ÇELA**,

Meqë po flitet për gratë dhe nënat që po presin jashtë për bijtë e tyre dhe për të afërmit e tyre që janë të zhdukur, mendoj që duhet të bisedojmë edhe për krijimin e një Komisioni që do të merrej me stusin e familjeve të dëshmorëve , të invalidëve të luftës dhe të veteranëve të luftës, të cilët mendoj se janë lënë pas dorës dhe mendoj se duhet të merremi me ta dhe të ndihmohen në mënyrë institucionale, mos të presim që edhe ata të daliin në grevë para Kuvendit që të na bie ndërmend që të merremi me ta . Edhe një çështje tjetër që kam pasur në plan ta shtroj në Komisionin për Kulturë por meqë ne nuk po mund të mblidhemi dhe nuk po kemi kuorum për shkak të mospjesëmarrjes së anëtarëve të atij Komisioni dhe e kisha dhënë një vërejtje shumë praktike para se të hartoni ndonjë ligj pak më konkret. Sa i përket gjuhës, unë kam vërejtë edhe në dokumente ka mangësi gjuhësore ka edhe mangësi gjuhësore në mënyrë të qëllimt do të thotë edhe nga përkthyesit zyrtarë dhe kisha kërkur nga administrata që t'u tërhiqet vërejtja që ata të përdorin gjuhën letrare, gjuhën e unisuar dhe jo gjuhët e tyre prej nga vijnë ose shpesh e bëjnë me qëllim, shpeshherë përdorin gegnishten apo diçka, mos ti japin ata vetit të drejtë që ata të vendosin për këtë çështje, janë vendet ku mund të vendoset për to. Gjuhë zyrtare njëherë lë të jetë gjuha letrare deri sa të mos ndryshohet, nëqoftë se ndryshohet ndonjëherë. Ju faleminderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, Ju faleminderit, vërejtje e qëndrueshme dhe vërejtje që kemi biseduar edhe radhët e tjera dhe besoj se duhet ndërmarrë hapa për të përmirësuar këtë, urdhëroni z. Deputet.

Verovatno je poslovnik u pitanju jer je tačka dnevnog reda razna, mora biti na početku sednice definisano o čemu će se raditi ova tačka koja mi imamo to je tačka pitanja i ona mora biti određena jednom mesečno ili u jednom određenom periodu gde će se postaviti pitanja to je svude u parlamentima a tačka razna kada se stavi u dnevni red i to se definiše možda jedna ili dva pitanja u kojima se može da se razmatra i utverde na početku sednice u kojim će pitanjima razmatrati pod razno to su dva pitanja ali ovo je moje mišljenje a ovako to su pitanja za Skupštinu odnosno za predsedništvo skupštine i tako pitanja se određuje jedna tačka na kraju sednice tog dana od toliko, toliko sati postavlja pitanja poslaničku ili Skupštinu, drugo komisija koja su u formiranju i koja treba da radi, ja mislim da njihov zadatak dobar međutim većina poslanika iz udaljenih centara mislim ne iz Prištine dobijali su materijale onda kada je sednica održana materijal se ostavlja ovde u fijkama i u ovim sefovima i onda danas su došli poslanici a komisija je održana juče, ili u utorak ili u ponedeljak, mislim da taj način obaveštavanja mora promeniti, ako ne može da stigne materijal onda se mora telefonom javlato članovima komisijama ili opšte da prisustvuju u tim sastancima možda su u privilegije oni koji su iz prištine, mada je većina poslanika iz Prištine isto je situacija oko dolaska na sednicu, ima poslanika koji su ovde iz Prištine i koji mogu da dodju ovde na sednici skupštine lakše, ima poslanika kojima je obezbeđen prevoz, međutim a ima poslanik koji dolaze iz trougla iz, Makedonije i Albanije i kojima treba 4 sata do Prištine i koji moraju da krenu u 6 sati izjutra i da se snalaze na bilo koji način ne postoji neki način prevoza organizovan koji postajao ranije da se može doći i to je problem mi ćemo pismeno podneti zahtev Skupštini da se nađe neko rešenje oko prevoza, hvala.

**Z. FATMIR SEJDIU**, ju falëminderit fjalën e ka deputeti anëtar i kreisë së Kuvendit z. Hydajet Hyseni, dhe do të dali me një propozim konkret rreth çështjeve që u shtruan posaqërisht rreth të zhdukurëve në Kosovë që është breng e përgjithshme e Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve të tjera, urdhëroni .

## Z. HYDAJET HYSENI,

Të nderuar deputetë të nderuar mysafirë bo bisedojmë lidhur me pikën e rendit të ditës çështje të ndryshme, Është pasojë e asaj që nuk kemi biseduar dhe se kemi regulluar me kohë , por ndoshta është rasti që të themi diçka dhe eventualisht të zëmë fillin. Po shifet qartë ka shumëçka të kalbur në Republikën tonë të Danimarkës, ka pak organizim, ka pak punë dhe për fatë të keq tepër politikë dhe ku ka një gjendje të këtillë sigurisht që nuk mund të ketë edhe efektivitet.

Unë do të përmendë vetëm disa nga mangësitë që po ballafaqohemi dhe dolën sot në sipërfaqe. Ne na është imponuar kështu siç na është imponuar të shqyrtojmë vetëm rregulloren për agjensinë për mirëbesimin siç është quajtur e është për privatizimin të cilën ne nuk kemi pasur asnjë mundësi për ndikim në hartimin e saj , përfaqësuesi special nuk e ka parë të arsyeshme , çdo respekt për punën e tijë por një vërejtje që nuk u theksua sa duhet qartë nuk e ka pa të arseshme që ti adresohet kuvendit në mënyrë zyrtare. Ju bëtë shumë vërejtje si është shpërndarë materiali , me të drejtë më besoni që kopjen që e keni ju ne e kemi siguruar në mënyrë private dhe ia kemi dhënë në momentin e fundit sekretarisë që të kopjohet dhe ti shpërndahet Kuvendit kurse në hyrjen e këtij dokumenti është thënë shprehimisht se përfaqësuesi special kësaj çështjen dhe çështjeve të ngjajshme do ti qaset siç edhe e kërkon Korniza në bashkëpunim me institucionet kosovare. Kuvendi është institucioni më i lartë i vetëqeverisjes në Kosovë. Kuvendi në këtë rast është a nashkuar plotësisht , ne sot po bisedojmë për çështje të ndryshme u kërkuar që të bisedoj me nënat të bisedon Kryesia, po në anën tjetër u tha që kryesia nuk mund të ndërtojë politika të Kuvendit dhe është e drejtë dhe unë pajtohem me një mendim të tillë, po çka t'u themi tash nënave qëndrimin e kujt tua themi , cilkat masa mund ti ndërmarim , çka është bërë për mijëra familje që janë ende të veshura në të zi dhe skërkojnë shumë kërkojnë vetëm të vërtetën, dhe është kërkuar ju lutem që kjo seancë të jetë solemne ne sod bisedojmë ngapak bëjmë edhe politikë a duhej të ishte kështu, a duhej të ishte kështu , kërkojmël që të zëm edhe dikën në pritë, ju lutem mund të keni edhe të drejtë, po si do të dukej kjo seancë sikur të ishte solemne dhe jasht i kemi nënat që kanë filluar grevën e urisë, p se solemne kështu na është propozuar që mbledhja e sotme të jetë solemne, pasi që ishte biseduar me kryetarin dhe ishte thënë një

qëndrim pse pikërisht sot të bëhet betimi dhe pse vetëm për një pjesë të organeve të Kosovës, mund të ketë qen jo e drejtë ajo, por çështja ka qen e shtruar keq, ka qen e shtruar vonë dhe ka qen e shtruar shumë pjesërisht prandaj që duhet marrë parasysh nënave nuk mund tu japim një përgjigje fët e fët siç është bërë herave tjera, dhe të bëjmë përsëri politikë por nëse duhet t'u japim një përgjigje duhet ti japim këtu përfaqësuesve të zgjedhur të Kosovës dhe bashkë me praninë ndërkombëtare këtu edhe ata janë përfaqësues të Kosovës edhe do të ishte mirë që edhe kur shqyrtojmë çështjen e agjensisë edhe çështjet tjera të jemi bashkë, të shqyrtojmë bashkë, të bisedojmë bashkë ne si Kryesi asnjëherë s'kemi pasur rast të bisedojmë me përfaqësuesit ndërkombëtar në Kosovë. Mund të dukej sikur po i vë avokatllëk siç më është thënë Kryesisë, as nuk më shkon ndërmend. E kam thënë publikisht dhe dua ta them përsëri, ka shumë shumë mangësi në punën e Kryesisë. Janë disa objektive dhe nuk varen prej saj është fillimi, është mungesa e përvojës është përvoja e keqe, janë kushtet të mjerueshme në të cilat punojmë mirëpo kjo nuk e shpjegon gjendjen në të cilën ndodhemi Kryesia punon pa rregullore, Kuvendi punon pa kalendarë të punës. Është propozuar që të rregullohen këto, nuk kemi arritur Kuvendi dhe Kryesia nuk di sa është buxheti i saj ose një informatë që e kemi marrë pas shumë insistimeve është krejt e pamjaftueshme Kryesia nuk ka asnjë qasje asnjë ndikim në ndërtimin e administratës së Kuvendit në rregrutimin e personelit për pasojë kemi shumël vërejtje shumë vështërsi në funksionimin e administratës. Nuk funksionon Kuvendi pa funksionim të administratës është thënë që sekretari i Kuvendit të jetë i fundit në radhën e regrutimeve, Kuvendi funksionon pa sekretar. Kuvendi ynë nuk ka kushte nuk ka asnjë dhomë, asnjë zyrë për komisione as për deputetë, dhe një mori problemesh tjera. Ne kërkojmë dhe flasim për transparencë në raport Kuvendi, opinioni medijat etj. Ne nuk kemi transparencë as në mes veti keni të drejtë dhe do ta shkurtojë, i thash të gjitha këto për ta pasqyruar realisht gjendjen. Kemi vështërsi të brendshme, kemi vështërsi objektive kemi edhe subjektive por çështjet nuk i zgjidhim po nuk zëmë fillin siç duhet, Kuvendi duhet të ketë kalendarin e aktivitetit të tij, duhet ta planifikojë edhe gjithë aktivitetin e tij, t'i zgjidhë çështjet praktike që e pengojnë atë, të ndërtojë raporte adekuate dhe funksionale dhe komplementare me praninë ndërkombëtare dhe të mos lejojë as prirjen për konfrontime krejt absurde, poashtu as prirjen për lojëra politike dhe servileizëm që nuk na sjell asgjë të mirë as ne

as pranisë ndërkombëtare në Kosovë dhe për fund propozoj që Kuvendi të dalë me një deklaratë për çështjen e të zhdukurve dhe ta aprovojmë bashkarisht në të cilën do të përqëndrohej së paku në dy çështje të kërkojmë nga të gjithë faktorët që mund të ndihmojnë dhe të zbardhin çështjen e të zhdukurve kosovarë që janë më se 3 mijë dhe të kërkohet që edhe bashkëpunimi me Qeverinë e Serbisë dhe të Jugosllavisë të kushtëzohet me një çasje pozitive në këtë drejtim dhe me akte të vullneti të mirë të cilat deri më tani kanë munguar. Mendoj se këtë çështje duhet ta bëjë Kuvendi dhe jo Kryesia e Kuvendit .

**Z. FATMIR SEJDIU**, Ju falënderit. Ndëgjuat edhe propozimin konkret, është edhe deputetja z. Sanije Alijaj e paraqitur, ju lutem keni kujdes me kohë paraqituni.

In deruari kryesues, dhe Kryesi e Kuvendit, të nderuar deputetë mu dhe juve sot na kanë përfshirë dy shqetësime, të zhdukurit dhe familjet e të zhdukurve që i kemi para Kuvendit, natyrisht që ata duanë përgjigje të matur dhe përgjegje për t'i gjetur të zhdukurit e tyre. Në fillimi kisha propozuar kryesisë së Kuvendit të formojë Komisionin që është inicuar nga deputetët e tjerë, dhe kam doronë se institucionet e Kosovës, nuk i kanë të gjitha të dhënat për pasojat e luftës në Kosovë. E di që shumë shoqata dhe Këshilli për të Drejtat dhe liritë e Njeriut, por edhe ndërkombëtarët kanë bërë përejkje për t'i evidentuar, por konsideroj se shumë shpejt dhe urgjentisht institucionet e Kosovës duhet ta kenë informacionin e tyre të saktë, sa të vrarë civile i kanë, sa ushtarë, sa të zhdukur sa të burgosur, sa të plagosur, se vetëm në atë formë së paku me një element do të bëjmë një zbutje të dhembjeve të tyre të mëdha. Mendoj, se sot para nënave që presin dhe para familjarëve aty para Kuvendit të Kosovës duhet ti dilet jo vetëm përfaqësuesit e Kryesisë së Kuvendit, mendoj se është mirë një përfaqësues i Kryeisë së Kuvendit kryesuesi i Kuvendit, dy deputetë të Kuvendit dhe një ndërkombëtar të dalin dhe së paku tju thojnë se brengat dhe shqetësimet e tyre janë edhe brenga dhe shqetësimi ynë dhe do të bëjmë çmos për zbardhjen e fatit të tyre dhe përpjekjet të jenë maksimale, propozimi tjetër është dje në tër komunat e Kosovës është festuar dita e çlirimit të Kosovës, përkatësisht hyrja e forcave ndërkombëtare në Kosovë, është brengë e imja si deputete së paku pse su mbajt kjo seancë mu dje së paku edhe ne në një formë me një

fjalë të rastit ta kishiim shenuar këtë ditë kaq të madhe për popullin në Kosovës. Ju faleminderit.

**Z. FATMIR SEJDIU**, Ju faleminderit, ju kisha lutur deputetëve që të jemi vërtet racional. Disa propozime që u dhanë më heret më duket se koincidojnë në një çështje, do të jetë tepër e nevojshme që në këtë pikë të rendit të ditës të të keni formulime konkrete do të thotë të jetë çështja e rendit të ditës për pyetjet që do të shtrohen, qoftë Kuvendit, qoftë Kryesisë, ekzekutivit etj. Dhe çështje të tjera dhe kështu po që se ne do të tentojmë që sot të hargjojmë krejt kërkesat dhe pyetjet do të jemi në pafundësi të propozimeve dhe kërkesave, një gjë jua them se të gjitha propozimet që kanë ardhur edhe në rugë zyrtare qoftë përmes vetë deputetëve si inisiativë e tyre, qoftë përmes komisioneve kan arritur në kryesinë e Kuvendit dhe do të hyjnë në proces, edhe ajo që u tha atje rreth ligjit mbi propozimin e z. Kelmendi dhe të tjerë, do tu kisha lut që të ndaleni rreth propozimit që tha kryetari i kresisë z. Hydajet Hyseni që Kuvendi në këtë ditë të takimit të tijë duke pasur para sysh brengën e përhershme për fatin e të zhdukurëve të Kosovës që su dihen gjurmël as shenja të tjera të shpreh pra mendimin e vetë duke insistuar edhe në instituconet më të larta të tjera themi të karakterit ndërkombëtar në Kosovë KFOR-i dhe UNMIK-u që të mirren masa më të domosdoshme. unë do të propozoja nëse ju pajtoheni që të hartohet një tekst i shkurtër në përmbajtje të mbështetjes së kërkesave të tyre unë do të propozoja z. Hydajet Hysenin, z. Niman Alimusa, z. Sabit Rrustemi dhe Nafije Gash, a pajtoheni që ky grup mbas një kohe të shkurtër të një pauze që do ta bëjmë ta 30 minutshe të hartojë një tekst me të cilin ne do të dalim thjesht duke shprehur brengën dhe qëndrimin tonë, ju faleminderit paузë.

**Z. FATMIR SEJDIU**, do ta lusja z. Hydajet Hysenin që ta lexojë tekstin

**Z. HYDAJET HYSENI**, ju kërkujmë falje për vonesën, ndoshta do të ishte më mirë që teksti do të ishte shumëzuar dhe do ta kishit në tavolinë, por për të kursyer kohë ne tham ta lexojmë nëse e konsideroni të nevojshme mund ta bëjmë shpejt.

Tekstin do të ishte mirë ta shikojmë dhe të plotësohet sepse duke e bërë shpejt e shpejt nuk kishim kohë që të shkruajmë si duhet lë vend për të dëshirueshëm, teksti kështu është:

Të shqetësuar seriozisht për fatin ende të pa zbardhur të mijëra qytetarëve të Kosovës të rrëmbyer vite më parë nga nga formacionet policore , militare e paramilitare serbe dhe të humbur pa gjurmë, duke u solidarizuar me kërkesat e ligjshme të mijëra familjeve për zbardhjen e fatit të më të dashurëve të tyre, të motivuar nga synimi për të ndërtuar një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme në një Kosovë të lirë demokratike , tolerante pluraliste ne deputetët e Kuvendit të Kosovës lëshojmë këtë deklaratë: Familjarizohemi me dhembjen dhe vuajtjen e gjatë të nënave dhe të bashkëfamiljarëve të tjerë për fatin e mirëja bijave dhe bijëve të rrëmbyer dhe të tretur pa gjurmë dhe mbështesim fuqimisht kërkesat e tyre të ligjshme për ndriqimin e fatit të tyre . Kërkojmë nga qendrat ndërkombëtare të vendosjes dhe prania ndërkombëtare në Kosovë që të ushtrojnë gjithë influencën e tyre mbi Qeverinë e Beogradit për ndriqimin e pengjeve të zhdukur kosovarë duke përfshirë edhe kushtëzimin e bashkëpunimit dhe normalizimit të marrëdhënieve me Beogradin me zgjidhjen sa më të shpejtë të kësaj çështjeje të dhembshme.

Duke mbajtur peng njerëz të pafajshëm , duke mbajtur peng të vërtetën për ta , mbahet peng edhe procesi i normalizimit të gjendjes në Kosovë dhe ndërtimi i marrëdhënieve normale të bashkëpunimit dhe të fqinjësisë së mirë në regjion.

Ndriçimi i çështjes së të zhdukurve dhe nxjerrja e fajtorëve para drejtësisë lehtëson procesin e normalizimit të gjendjes së përgjithshme të gjendjes në Kosovë. Kuvendi i Kosovës d të themelojë një Komision të posaqëm parlamentar për ta ndjekur në vazhdimësi dhe në rrugë institucionale çështjen e të gjithë qytetarëve të Kosovës që konsiderohen të zhdukur.

**Z. FATMIR SEJDIU**, dëgjuat tekstin, a pajtoheni me këtë përmbajtje. Ju falënderit. Deputetë të kuvendit të Kosovës të kenë parasysh se grupi i nënave dhe i anëtarëve të familjeve të të zhdukurve janë në protestë para Kuvendit të Kosovës dhe mendoj se është borgj e gjithë neve që ta shprehim edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë këtë pjesë të shqetësimit, të këtij dokumenti dhe të asaj që ne e ndjejmë për të zhdukurit e Kosovës.

Sigurisht se nga ky moment natyrisht se do të kemi parash një angazhim edhe më këmbëngulës edhe të institucioneve të Kosovës pra edhe duke insistuar te faktori ndërkombëtar që ka kompetenca më të bollshme të bëjë të mundurën për gjithë këto kërkesa për të ndriqar fatin e e njerëzve të Kosovës që nuk janë në mesin e familjeve të tyre. Kaq edhe po e përfundojmë seancën.